



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Psikologji
Edukimi”**

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Asoc. Dr. Eralda Zhilla
Dr. Blerina Hamzallari**

Qershor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në “Psikologji Edukimi” ofruar nga Universiteti “Aleksandër
Xhuvani”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave "Psikologji Edukimi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 90, datë 24.02.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 669, datë 29.12.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5PAE/4PAK v.a.2022-2023 7PAE/6PAK v.a. 2021-2022 8PAE/3PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	2019-2020 13 2020-2021 13 2021-2022 11
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Psikologji Edukimi” është hapur me Urdhër Ministri Nr. 90, datë 24.02.2011 dhe ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Univeristetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Njësia bazë e Departamentit të Psikologjisë është pjesë e strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, i cili përbëhet nga 5 njësi bazë. FSHE është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 821, datë 5.12.2007 si bashkim i ish-Fakultetit të mësuesisë dhe ish-Fakultetit të Shkencave Sociale. Profili i studimeve në Psikologji është ofruar si fillim pranë Departamentit të Psikologjisë dhe të Sociologjisë me Miratim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës me Nr. 2862 prot., datë 28.04.2005, më pas me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 821, datë 5.12.2007 profili i studimeve psikologjike do të ofrohej në Departamentit e ristrukturuar si Departamenti i Psikologjisë, Sociologjisë dhe Shkencave të Edukimit. Departamenti i Psikologjisë i mëvetësuar ka filluar të funksionojë si strukturë më vete në Fakultetin e Shkencave të Edukimit me Vendim Senati Nr. 19, datë 27.06.2011. Programi i ofruar është i organizuar sipas nivelit 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, forma e studimeve është me kohë të plotë me një kohëzgjatje të studimeve në 2 (dy) vite akademike, përgjatë të cilave studenti fiton 120 ECTS. Programi i studimit është organizuar në dy vite me nga 60 kredite në secilin vit, përkatësisht 1500 orë mësimore të organizuara në modalitetet e verpimtarive të pavarura dhe veprimtarive në auditor.

Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe dhe është i organizuar në lëndë dhe module lëndore sipas tipeve të veprimtarive formuese të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Europian të transferimit dhe të grumbullimit të krediteve (ECTS). Në përfundim të programit të studimeve studentët pajisën me diplomën “Master i shkencave” në “Psikologji Edukimi” dhe me suplementin përkatës në gjuhën Shqipe dhe Angleze në përputhje me elementët e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 11, datë 2.4.2020 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës.

Kurrikula e programit të studimit është hartuar dhe organizuar në përputhje me zhvillimet e fushës dhe në përgjigje të interesave dhe nevojave kombëtare. Gjatë zhvillimit të programit të studimit ofrohet literaturë e pasur në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, duke mundësuar ndërthurjen e përvojave studimore vendase dhe ndërkombëtare të fushës së studimit në psikologji dhe veçanërisht në psikologji edukimi. Programi i studimit “Master i shkencave” në “Psikologji Edukimi” është hartuar dhe ofrohet në zbatim dhe në përputhje me strategjinë për zhvillim institucional të Univeristetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Departamentit të Psikologjisë si dhe në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Edukimit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, Kreu X: Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, mbështetur në VKM nr. 109 për organizimin e ASCAL dhe në Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017, për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e studimit “Master i shkencave” në “Psikologji edukimi” ofruar nga Departamenti i Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ASCAL ka ngritur grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ) të përbërë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit Prof. Asoc. Dr. Eralda Zhilla dhe Dr. Blerina Hamzallari. Gjatë procesin të vlerësimit të jashtëm grupi I ekspertëve është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc. Endra Velaj.

Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm është bazuar në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) të grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit në vlerësim, dokumentacionin shoqërues të RVB-së dhe informacionin e grumbulluar përgjatë takimeve të organizuara me aktorë të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Psikologji edukimi” gjatë vizitave në Institucion të mbajtura në data 14-15 dhjetor 2022. Vizitat në institucion janë mbajtur sipas agjendës së miratuar nga ASCAL, e cila i është njoftuar paraprakisht Univeristetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” sipas parashikimeve të akteve rregullatorë të ASCAL.

GVJ ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme RVB-në dhe dokumentacionin shoqërues të saj, përpara vizitave të institucion në mënyrë që të zhvillonte një takim të mirëinformuar paraprakisht me aktorët e programit të studimit. Gjatë vizitës dy ditore (14-15 dhjetor 2022) në Univeristetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UE) u mbajtën takime me drejtuesen e njëjës kryesore dhe drejtuesen e njësisë bazë ku ofrohet programi i studimit në vlerësim, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentët e programit të studimit, me personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, me sekretarinë mësimore, me përfaqësues të Drejtorisë së kurrrikulave dhe Sigurimit të brednshëm të cilësisë, me përfaqësues të Drejtorisë së Këshillimit të karrierës dhe Alumni, me përfaqësues të Komisionit të standarteve të cilësisë në IAL dhe në Fakultetin e Shkencave të Edukimit (FSHE), me përfaqësues së Drejtorisë së kooordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë, me përfaqësues të drejtorisë së burimeve njerëzore, gjithashtu u zhvilluan vizita në mjedise të FSHE dhe UE si në biblioteka, mjedise studimi, auditore, laboratorë, në mjediset e shërbimeve të ndryshme për studentë, etj.

Draftimi i raportit të vlerësimit të jashtëm (RVJ) ka filluar pas vizitës dy ditore në institucion dhe procesi është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc. Endra Velaj. Draft raporti i vlerësimit të jashtëm është përcjellë nga ASCAL për njohje në UE nëpërmjet sistemit elektronik dhe me shkresë zyrtare me Nr. 2/45 Prot., datë 3.4.2023 me objekt “Njoftim për dërgimin e draft-raportit të vlerësimit të jashtëm”. Universiteti i Elbasanit, pas njohjes me draft-raportin e vlerësimit të jashtëm në përgjigjen dërguar ASCAL me anë të shkresës Nr. 642/19 Prot., datë 11.04.2023 ka shprehur reflektimet ndaj draft-raportit, të cilat u shqyrtuan nga grupi i vlerësimit të jashtëm përpara hartimit të raportit përfundimtar të vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm pas njohjes me shkresë-përgjigjen e Universitetit të Elbasanit reflektoi në raportin përfundimtar si më poshtë vijon:

- 1- Grupi i vlerësimit të jashtëm rishqyrtoi raportin e vlerësimit të jashtëm në lidhje me standartin I.1. kriteri 4, Standartin II.3. kriteri 1., kriteri 3, duke konsideruar rregulloren e ridërguar të programit të studimit me shkresë përgjigjen pas njohjes me draft raportin, duke njohur “gabimin teknik” në rregulloren e programit të studimit të depozituar në fazën e parë me dokumentacionin shoqërues të raportit të vlerësimit të brendshëm.

- 2- Në lidhje me arsyetimin e përcjellë mbi standartin I.3. Kriteri 3, për mungesën e mobilitetit të studentëve për programin e studimit MSC PE të ndikuar nga kushtet e pandemisë, GVJ-ja ka vlerësuar me kujdes faktet dhe në po të njëjtën periudhë ka patur mobilitete të përcjella në dokumentacion nga UE për programe të tjera studimi dhe për personelin akademik, sikurse janë evidentuar edhe në RVJ. Në këtë kriter qëndron sugjerimi i GVJ-së për Departamentin e Psikologjisë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit, për të patur evidenca konkrete përtej dëshmime verbale.
- 3- Në lidhje me komentin e përcjellë nga institucioni për standartin II.1. kriteri 1 dhe kriteri 3, GVJ-ja në këto kritere ka analizuar në mënyrë të detajuar (pa)përputhshmërinë e planit mësimor të programit të studimit me legjislacionin vendas në fuqi, duke evidentuar ndryshimet e bëra në mënyrë progresive për 3 cikle studimi të ndryshme. Dhe në përfundim rezulton se edhe në planin e vitit akademik 2022-2023 (cikli studimit 2022-2024), ka papërputhshmëri me legjislacionin në përkatësinë e lëndëve të komponentit mësimor të kategorisë A dhe C, sikurse dhe është sqaruar gjatë analizës së këtyre kritereve nga GVJ-ja.
- 4- Në lidhje me arsyetimet mbi standartin II.3, kriteri 2 GVJ-ja ka arsyetuar rreth dokumentacionit të përcjellë dhe evidencave në dispozicion.
- 5- Për argumentin e institucionit ndaj analizës së bërë nga GVJ-ja në standartin II.3. kriteri 5, GVJ-ja sjell në vëmendje së është shprehur për faktin e munguar të ndryshimit në përmbajtje të planit mësimor sipas evidencave në administrim (planet mësimore për ciklet e studimeve 2019-2021, 2020-2022, 2022-2024) dhe jo për procedurën e ndryshimit të planit të shprehur në aktet rregullative të institucionit.
- 6- Në lidhje me arsyetimin e përcjellë nga institucioni për standartin II.5., kriteri 3, GVJ-ja ka analizuar mbi bazën e evidencave të përcjella dhe përmbajtjes së tyre.
- 7- Në lidhje me arsyetimin në standardin IV.1, kriteri 5 GVJ vlerëson përpjekjen e departamentit për fillimin e punës për hapjen e një laboratorit në fushën e psikologjisë, por sërish mbetet një iniciativë fillestare e papërfunduar. Ndërkohë për kriterin 7 dhe 8 në të njëjtin standard, qëndron sërish sugjerimi GVJ për një shpërndarje më të barabartë të orëve të praktikës në radhët e personelit akademik, gjë që u konfirmua edhe gjatë intervistës në institucion.
- 8- Në lidhje me arsyetimin mbi standardin IV.3 grupi vlerësimit të jashtëm ka reflektuar mbi dokumentacionin e përcjellë dhe evidencat në dispozicion, duke e klasifikuar si të përmbushur plotësisht si standard.
- 9- Për argumentin në standardin IV.4, GVJ sjell në vëmendje se ka rekomanduar që të gjitha procedurat të kanalizohen edhe në nivel fakulteti ku mund të përfitojë më shumë secili program studimi duke qenë më pranë njësisë bazë. Megjithatë duke reflektuar sërish mbi dokumentacion dhe mënyrën e organizimit të punës në këtë universitet, GVJ merr në konsideratë kthim përgjigjen e institucionit. Me të gjitha ndryshimet dhe dokumentacionin e mbështetur, GVJ gjykon që ky standard mund të klasifikohet i përmbushur plotësisht.
- 10- Përsa i përket standardit VI.1 në secilin kriter ku grupi vlerësimit të jashtëm ka bërë komentet përkatëse theksojmë se institucioni nuk ka mbështetur me dokumentacion

përgjigjen që ka kthyer. GVJ ka cituar që vlerësimi nëpërmjet pyetësorëve është zhvilluar në nivel universiteti, por nuk janë përfutur të dhëna të detajuara në nivel programi studimi, ndaj mbetet i mendimit për ta klasifikuar si një standard të përmbushur kryesisht. Në tërësi standardi i fundit është një nga pikat e dobëta të këtij programi studimi ku sapo ka nisur puna lidhur me vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Me të gjitha komentet dhe përgjigjet e dhëna nga institucioni, mbështetur edhe në dokumentacion shoqëruar në disa raste, GVJ e klasifikon të gjithë standardin të përmbushur kryesisht. Meqënëse nuk ka dokumente specifike që mbështesin analizën e kthimit të përgjigjës në secilin standard, GVJ ka rianalizuar edhe njëherë cdo kriter dhe në fund ka gjykuar që ky standard i përmbush kryesisht kriteret lidhur me sigurimin e cilësisë së këtij programi studimi.

Raporti final është hartuar pas komunikimit përfundimtar me UE mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Psikologji Edukimi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT



Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Aleksandër Xhuvani” është institucion publik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili në misionin e tij ka të përcaktuar qartë orientimin e veprimtarisë së tij për formimin e specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar duke kontribuar në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare. Në Statutin e Universitetit të Elbasanit (2022), neni 2: Misioni (pika b, d, e) deklarohet se: “Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si institucion i arsimit të lartë ka për mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; d) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare; e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit”. <i>(1.1. Statuti i UNIEL)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji Edukimi” (Msc. PE.) është hapur me Urdhër Ministri Nr. 90, datë 24.02.2011 dhe ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë (DP), krijuar me Vendim Senati Nr. 19,

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>datë 27.06.2011 në Fakultetin e Shkencave të Edukimit (FSHE) të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” (UE). <i>(1.18. Vendimi për hapjen e programit të studimit; 1.15, Vendimi për hapjen e departamentit)</i> Programi i studimit ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së Njesisë bazë dhe Njesisë kryesore. Në dokumentat themelore të programit të studimit MSc. PE dëshmohet se programi është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me qëllimin dhe misionin e UE. Në strategjinë e zhvillimit të programit të studimit pika II. Vizioni, Misioni deklarohet se: “Departamenti i Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit Aleksander Xhuvani, Elbasan ka si vizion të përmirësojë kurrikulat ekzistuese sipas kërkesave dhe zhvillimeve të reja shoqërore dhe tregut të punës; Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë psikologë profesionistë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; ... arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombetare në fushën e mësimdhënies.” <i>(1.19 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; 1.20. Rregullore e programit të studimit, neni 6: Misioni)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë MSc. PE është hartuar dhe ofrohet në zbatim dhe në përshtatje me strategjinë për zhvillim institucional të UE, të rregullores së organizimit dhe të funksionimit të UE, të rregullores së studimeve në UE dhe në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Departamentit të Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.</p> <p>Përbushja e këtij kriteri në ofrimin e programit Msc. PE duket qartë në koherencën dhe kohezionin e vizionit, qëllimit dhe objektivave të ofrimit të programit të studimit, të cilat ndërtohen në frymën e zhvillimit të strategjisë institucionale dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullative të UE.</p> <p>Sipas Statutit të UE (2022), neni 5 dhe neni 7 në Strukturën e UE në njësinë kryesore të Fakultetit të Shkencave të Edukimit ndodhet njësia bazë e Departamentit të Psikologjisë, e cila ofron edhe programin e studimit MSc. PE. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Statutin e UE, neni 50 dhe rregulloren e studimeve në UE, kreu II, neni 15 sipas të cilave “Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësi për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe: a) Organizohen më jo më pak se 120 (njëqind e njëzet) kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike; b) Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" përmbillen me purim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplome "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer”. Sipas Kornizës konceptuale, kreu III të programit të studimit MSc. PE “Disiplinat mesimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite sipas tipologjive të veprimtarive formuese (A-E)”.</p>

	<p>(1.1. Statuti i UNIEL; 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; 2.15 Korniza konceptuale e programit te studimit).</p> <p>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit është ndërtuar gjithashtu, bazuar në shtyllat e strategjisë së Institucionit. Ndër shtyllat kryesore të koherencës së zhvillimit strategjik të programit të studimit me strategjinë e institucionit mund të përmendim: kurrikulën, ndërkombëtarizimin, zhvillimin e partneriteteve, studentët.</p> <p>(1.19 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; 1.3 Strategjia e UNIEL)</p>		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të depozituar në e-ascal, programi i studimit Msc. PE është hapur për herë të parë në UE me Urdhër Ministri Nr. 90, datë 24.02.2011. Në raportin e vlerësimit të brendshëm, përmbushja e këtij kriteri është orientuar bazuar në rregulloren e programit të studimit si bazë dokumentacioni. Rregullorja e programit të studimit ridërguar në e-ascal pas marrjes dijeni për draft raportin e vlerësimit të jashtëm rezultoi të jetë e vitit 2022 dhe është një dokument themelor për programin e studimit, i cili justifikon qëllimin e hartimit të programit dhe reflekton se programi i studimit përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe në fushën e profesioneve të rregulluara, sikurse është profesioni i psikologut.</p> <p>(1.20 Rregullore e programit të studimit, 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; 1.19 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; 1.17 Rregullore e Departamentit; 1.16 Strategjia e zhvillimit te Departamentit)</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Referuar dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni i Arsimit të Lartë rezultoi se Universiteti i Elbasanit ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Në hartimin dhe politikat e zhvillimit të programeve të studimit synohet zhvillimi i interesave dhe vlerave kombëtare si dhe ruajtja e tyre. Programi i studimit "Master i shkencave" në "Psikologji Edukimi", ofruar nga Departamenti i Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit të Elbasanit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të Universitetit të Elbasanit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën</p>	<p>Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, dt.12.11.1991, akredituar nga Agjencia e Sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë me 6 vite, nëpërmjet vendimit</p>

<p>akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>të Bordit të Akreditimit Nr. 49, datë 27.11.2020. UE ka në përbërje të tij 5 njësi kryesore dhe 26 njësi bazë.</p> <p><i>(1.1. Statuti UNIEL, neni 5; 1.6. Çertifikata e akreditimit Institucional)</i></p> <p>Njësia bazë e Departamentit të Psikologjisë është pjesë e strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, i cili përbëhet nga 5 njësi bazë. FSHE është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 821, datë 5.12.2007 si bashkim i ish-Fakultetit të mësuesisë dhe ish-Fakultetit të Shkencave Sociale. Profili i studimeve në Psikologji është ofruar si fillim pranë Departamentit të Psikologjisë dhe të Sociologjisë me Miratim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës me Nr. 2862 prot., datë 28.04.2005, më pas me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 821, datë 5.12.2007 profili i studimeve psikologjike do të ofrohej në Departamentit e ristrukturuar si Departamenti i Psikologjisë, Sociologjisë dhe Shkencave të Edukimit. Departamenti i Psikologjisë i mëvetësuar ka filluar të funksionojë si strukturë më vete në Fakultetin e Shkencave të Edukimit me Vendim Senati Nr. 19, datë 27.06.2011. Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji Edukimi” (Msc. PE.) është hapur me Urdhër Ministri Nr. 90, datë 24.02.2011 dhe ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë.</p> <p><i>(Organigrama e FSHE, 1.18. Vendimi për hapjen e programit të studimit; 1.15. Vendimi për hapjen e departamentit).</i></p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, FSHE deklaroi se për vitin akademik 2021-2022 ka patur të angazhuar gjithsej 91 pedagogë, prej të cilëve 39 me statusin e personelit akademik me kohë të plotë prej të cilëve: 3 të kategorisë Prof. Dr.; 15 të kategorisë Prof. Asoc.; 14 të kategorisë Dr.; 4 të kategorisë Doc. Dr.; 1 të kategorisë Doc.; 2 të kategorisë MSc. Nga personeli akademik i FSHE 52 pedagogë janë të angazhuar me kontratë me kohë të pjesshme, prej të cilëve: 5 të kategorisë Prof. Dr.; 7 të kategorisë Prof. Asoc.; 13 të kategorisë Dr.; 1 të kategorisë Doc.; 2 dr. në process, 24 të kategorisë MSc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Psikologjisë, si departamenti përgjegës i ofrimit të programit të studimit MSc. PE deklarohet të ketë patur për vitin akademik 2021-2022, 7 personel akademik të angazhuar me kohë të plotë (PAE) dhe 12 personel akademik me kontratë (PAK). Nga PAE në DP rezulton se: 1 pedagog është i kategorisë Prof. Dr.; 2 pedagogë janë të kategorisë Prof. Asoc.; 4 pedagogë janë të kategorisë Dr. Nga PAK në DP rezulton se: 2 pedagogë janë të kategorisë Dr dhe 10 janë të kategorisë Msc.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 1).</i></p> <p>Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë programi të studimit MSc. PE, pasi në shtesë të sa më sipër është nëvizuar, edhe në situacionin e shpërndarjes së personelit akademik sipas</p>
---	--

	<p>planit mësimor rezulton se DP në çdo rast nga viti akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023 përmbush kriterin e standarteve të cilësisë në arsimin e lartë për të mbuluar të paktën 70% të ngarkesës mësimore në programin e studimit me personel akademik me kohë të plotë.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabelat 12¹-12⁴, 2.16. CV e personelit akademik dhe ndihmesakademik për programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit të studimit Msc. PE., programeve lëndore dhe dokumentit të rregullores së Studimeve në FSHE rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, FSHE, që është njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit. Përputhshmëria e fushës së studimit në programin MSc. PE me njësinë kryesore është konform direktivave dhe udhëzimeve Europiane si: International Standard Classification of Education: Fields of Education and Training 2013¹ dhe Manuali i Frascatit (2015)² dhe atyre kombëtare, të cilat iu përmbahen direktivave evropiane të klasifikimit dhe kodifikimit.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 10, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, Rregullore e studimeve në FSHE- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit të Psikologjisë, në nenin 6 të saj deklarohet qartë se: “DP ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, ku organizimi, struktura dhe përmbajtja e këtyre programeve, ofrohen në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimet akakademike të DP-së, si edhe në përputhje të plotë me klasifikimin/ kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit shqiptar të fushës, si edhe direktivave evropiane në ato raste kur këto direktiva janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë”. Programi i studimit në tërësinë e gjithë elementëve të tij organizativë dhe përmbajtësorë përputhet me fushën akademike e kërkimore të DP-së si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p><i>(1.17. Rregullore e departamentit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit MSc. PE.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të</p>	<p>Referuar Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe evidencave në dispozicion rezulton se UE ofron trajnime profesionale të vazhdueshme</p>

¹ [Field Descriptions \(unesco.org\)](http://unesco.org)

² [Frascati Manual 2015: Guidelines for Collecting and Reporting Data on Research and Experimental Development | en | OECD](http://www.oecd.org/dataoecd/1/1/47691312.pdf)

mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>për studentët e tij. Në listën e trajnimeve të zhvilluara për studentët në intervalin kohor 2020-2022 mund të përmendim trajnimet: Si të luftojmë dezinformimin, Validimi i kompetencave në fushën e marketingut të shërbimeve dhe sjelljes konsumatore, Integrimi i studentëve në tregun e punës, Klubi I debatit, Akademia e Medias, etj. (1.10. Lista e trajnimit të studentëve)</p> <p>Gjatë vizitave në institucion u evidentua se në lidhje me programin e studimit Msc. PE., për trajnimet e të pas diplomuarve partneri kryesor është Urdhri i Psikologut, pranë të cilit departamenti ka përfaqësuesit e tij dhe koordinojnë në bashkëpunim trajnimet e vazhdueshme pasdiplomimit dhe në funksion të aftësimit për tregun e punës dhe ndryshimet e tij. (informacion nga vizita në institucion, 14.12.2022)</p>		
Konkluzione	<p>Bazuar në gjetjet dhe evidencat e kriterëve të standartit I.2, rezulton se programi i studimit MSc. PE. është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe të Departamentit të Psikologjisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ofruar në Universitetin e Elbasanit.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Organizimi akademik dhe administrativ i UE dëshmon rëndësinë e marrëdhënieve bashkëpunuese në nivele të ndryshme të organizimit brenda institucionit për mbarëvajtjen e programit të studimit MSc. PE. Fryma e bashkëpunimit shprehet nëpërmjet ndarjes së detyrave të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ në funksion të mbështetjes së punës së programit të studimit. (1.1. Statuti UNIEL, Kreu II, 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL, Rregullore e studimeve në FSHE- dokumentacion shtesë në e-ascal).</p> <p>Ndarja e detyrave mes njësive e personelit dhe marrja e përgjegjësisë përkatëse planifikohet që në fillim të vitit akademik, duke siguruar realizimin me sukses të procesit mësimor, praktikave, udhëheqjeve të diplomave dhe veprimtarive të tjera mbështetëse në funksion të procesit mësimor e kërkimor të programit të studimit. Njësitë bazë dhe personeli akademik i tyre ofrojnë ekspertizën e tyre në përmushje të kuadrit të veprimtarisë në programin e studimit MSc. PE., ashtu sikurse edhe personeli akademik i DP ofron ekspertizën e tij në funksion të</p>

	<p>mbarëvajtjes së proceseve të punës në njësi të tjera bazë të njëjësive kryesore të UE.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabelat 12¹-12⁴, Aneksat e RVB-tabela 4, Aneksat e RVB-tabelat 6)</i></p> <p>Në funksion të mbikqyrjes dhe mbarëvajtjes së programit të studimit të gjithë aktorët e përfshirë raportojnë mbi punën e tyre dhe në praktikën e punës së DP analiza e punës shprehet ne raportin për veprimtarinë e programit të studimit, i cili ndrtohet në tre shtylla bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ne zhvillimin e procesit mesimor, 2. Per pasurimin e informacioneve te kurrikules 3. Zhvillimi i aktiviteteve shkencore. <p>Të dhënat e plota të analizës së punës së DP përfshihen në analizën vjetore të punës së departamentit dhe më pas në analizën vjetore të UE.</p> <p><i>(3.15 Raport vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, 4.18 Raport per veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në dokumentin e strategjisë së zhvillimit të Institucionit 2020-2024, UE për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve paraqet si objektiva strategjike zhvillimin e bashkëpunimit dhe të ndërkombëtarizimit. Sipas këtij dokumenti në kuadër të ndërkombëtarizimit: “UE do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndërkombëtarizuar dhe për të shtrirë më tej bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar me universitete dhe institucione të arsimit të lartë. ... Kjo do të arrihet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rritjes së numrit të bashkëpunimeve për realizimin e mobiliteteve; - aderimit në shoqata dhe organizata ndërkombëtare; - pjesëmarrjes në projekte për ngritjen e kapaciteteve; etj.” <p>Në kuadër të bashkëpunimit me institucione synohet: “të rritet bashkëpunimi jashtë UE-së duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me interes të përbashkët me të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik në Shqipëri, me Kuvendin, bashkitë, drejtoritë rajonale, ministritë etj. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit përmban rreth 60 institucione vendase dhe të huaja, ndër të cilat mund të përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Marrëveshjen e bashkëpunimit me Universitetin “Aldo Moro”, Bari, Itali. 2- Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" 3- Akademia Shqiptare e Arteve dhe Shkencave 4- Universiteti i Tiranës 5- Universiteti “Fan S. Noli” 6- Universiteti i Arteve 7- International Institute for Culture Diplomacy 8- University of Neë York Tirana 9- Valga County Vocational Training Centre

	<p>10- Universiteti "Fan Noli", Korçë 11- The United States Agency for International Development (USAID). The East-Eest Management Institute ("EËMI") Justice for All Project in Albania ("JFA") 1 12- South-West University "Neofit Rilski" 13- Universiteti "Nënë Teresa", Shkup 14- Universiteti i Veliko Tarnovo, Bullgari 15- Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan, etj.</p> <p><i>(1.3 Strategjia e UNIEL, 2.20 Marrëveshje bashkëpunimi me Aldo Moro, 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Një element i rëndësishëm i procesit mësimor janë praktikat profesionale për të cilat UE vendos në dispozicion një listë me rreth 16 marrëveshje me institucione në të cilat studentët mund të kryesjnë praktikat profesionale varësisht profileve të tyre të studimit. Në listë mund të veçojmë institucione të rëndësishme për praktikat profesionale të programit të studimit MSc. PE si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Zyra e Shërbimit të Provës 2- Drejtoria Arsimore Rajonale 3- Bashkia Elbasan 4- Spitali Psikiatrik "Dr. Sadik Dinçi", Elbasan 5- Këshilli I qarkut, etj. <p><i>(Anekset e RVB-tabela 5, 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave)</i></p> <p>UE, FSHE dhe DP dëshmojnë se në veprimtaritë e tyre kërkimore shkencore bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushave të ndryshme. Disa veprimtari kërkimore të realizuara në bashkëpunim janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Konferenca e I-rë ndërkombëtare "Sfidat e kërkimit shkencor në Psikologjinë e aplikuar dhe të edukimit", 3 qershor 2022. 2- Konferenca e parë ndërkombëtare studentore "Shkenca e hapur dhe ndërkombëtarizimi", 29 prill 2022. 3- Konferenca shkencore studentore "Impakti i E-learning në performancën psikopedagogjike", 2 shkurt 2021, etj. <p><i>(3.12 Konferenca e departamentit Qershor 2022, 3.13 Konferenca studentore UE, 3.14 Konferenca studentore AU UFO, 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021)</i></p> <p>Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme mobiliteti nga të cilat përfitojnë personeli akademik dhe studentët. UE dhe DP dëshmojnë se si programin kryesor me anë të të cilit mundësohet mobiliteti i studentëve dhe personelit akademik është ERASMUS+. Partnerët kryesorë në kuadër të bashkëpunimit për mobilitetet Erasmus+ janë në Itali, Poloni, Bullgari, Rumani, Spanjë,</p>

	<p>Republikën Çeke, Turqi, Lituani, etj. Lista e partnerëve përbëhet nga 52 Institucione të Arsimit të lartë dhe Institucione kërkimore.</p> <p>DP ka patur 3 studentë përfitues nga programet e shkëmbimit Erasmus, por jo nga programi i studimit MSC. PE.</p> <p>Në intervalin 2019-2022 dhe 3 personel akademik të angazhuar edhe në programin e studimit MSc. PE kanë përfituar nga programet e shkëmbimit Erasmus +.</p> <p><i>(3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+, 3.2 Të dhëna për mobilitetin FSHE)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë, ku ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Edukimi” harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Këto të dhëna pasqyrohen në dokumeta si raporti vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, raporti për veprimtarinë e programit të studimit, analiza vjetore e departamentit.</p> <p><i>(3.15 Raport vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, 4.18 Raport per veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti i Elbasanit ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që Departamenti i Psikologjisë të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit, pasi nuk ka asnjë student përfitues shkëmbimesh nga programi i studimit nën akreditim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Kreu VII, neni 71 pika 2 dhe 3 shprehet si më poshtë:</p> <p>“Pika 2; Elementet që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”</p> <p>“Pika 3; Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statut dhe rregullore elemente të hollësishme për programet e studimeve që ato ofrojnë.”</p> <p>Në nenin 75 të Ligjit 80/2015 për programet e ciklit të dytë të studimeve, pika 1 dhe 3a përcaktohet se:</p> <p>Pika 1- “Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.”</p> <p>Pika 3a- “Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në:</p> <p>a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike.”</p> <p>Sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, duhet të jenë sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2, shprehet se: Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</p> <ol style="list-style-type: none"> kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; objektivat formues dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; planin mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; programin lëndor (Syllabus-et);

- i) profilin e programit;
- j) diplomën dhe suplementin;

Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Psikologji Edukimi” i përmban të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit sipas përcaktimeve të VKM 41 dhe kjo dëshkohet nëpërmjet evidencave të përcjella me dosjen e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.

(Aneksat e RVB-tabela 10, tabela 9, tabela 13, tabela 15; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; 2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit, Rregullore e studimeve në FSHE- dokumentacion shtesë në e-ascal, Plani mesimor _Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal, 3.7 Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit, modeli i diplomës, 3.9 Modeli i suplementit të diplomës të programit të diplomës)

GVJ konstaton se **programi i studimit në vlerësim ka papërputhshmëri me VKM 41, në peshën që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit në planin mësimor për ciklin e studimeve 2019-2021, 2020-2022**, që përkon edhe me periudhën për të cilën është dorëzuar dokumentacioni për vlerësim, krahasuar me përcaktimet e shtojcës nr. 1, tabela 1.

Nga analizimi i të dhënave të programit të studimit në dokumente të ndryshme rregullatore të tij rezulton si më poshtë vijon:

Kateg.	Komponenti	Vkm. 41 MSC. 2018	Plani mësimor	Korniza konceptuale	Kreditet Plani mesimor
A	Lëndë bazë	5-10%	8.3%	10%	10
B	Lëndë karakterizuese	50-60%	45%	45%	54
C	Lëndë ndërdisip/ Integruese	12-20%	18.3%	20%	22
D	Lëndë plotësuese	10%	11.7%	10%	14
E	Detyrime përmbyllëse	10-15%	16.7%	15%	20

(Aneksat e RVB-tabela 10, tabela 9, 2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit, Plani mesimor _Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021 dhe 2020-2022- dokumentacion shtesë në e-ascal)

Nga sa më sipër, Gvj konstaton se pavarësisht se VKM 41 ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2018, DP nuk ka bërë ndryshimet e nevojshme në planin mësimor të programit të studimit për përputhjen e peshës specifike të kategorive të veprimtarive formuese deri në vitin akademik 2022-2023 (cikli i studimeve 2022-2024).

Në planin mësimor të programit të studimit për ciklin e studimeve 2019-2021, 2020-2022 rezultojnë se gjenden 2 lëndë (10 ECTS=8.3%) që i përkasin kategorisë A të komponentit mësimor përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme; gjenden 8 lëndë (54 ECTS=45%) që i përkasin kategorisë B të komponentit mësimor mbi lëndë karakterizuese/përgatitje për disiplinën shkencore; gjenden 5 lëndë (22 ECTS=18.3 %) që i përkasin kategorisë C të komponentit mësimor mbi lëndë integruese dhe ndërdisiplinare; gjenden 2 lëndë (14 ECTS=11.7%) që i përkasin kategorisë D të komponentit mësimor mbi lëndë plotësuese si Gjuhë të huaja/ njohuri informatike/ praktika profesionale; gjendet gjithashtu një lëndë që i përket kategorisë E të komponentit mësimor detyrime përmbyllëse (20 ECTS=16.7%).

(Aneksat e RVB-tabela 10, tabela 9, 2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit, Plani mësimor_Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021 dhe 2020-2022- dokumentacion shtesë në e-ascal)

Gjatë vizitave në Institucion në datën 15.12.2022, GVJ kërkoi edhe planin e miratuar nga Senati Akademik për programin e studimit MSc. PE për vitin akademik aktual 2022-2023 (cikli i studimeve 2022-2024), vënë në dispozicion në dokumentat shtesë pas vizitës në institucion. **Edhe pse në programin e studimeve Msc. PE., për vitin akademik 2022-2023 nuk ka studentë të rregjistruar në vitin e parë,** GVJ konstaton se në planin mësimor të programit të studimit për ciklin e studimit 2022-2024 është realizuar përputhja e peshës specifike të kategorive të veprimtarive formuese me VKM 41.

Kateg.	Komponenti	Vkm. 41 MSC. 2018	Plani mësimor 2022-2024	Nr. i lëndëve	Kreditet ECTS
A	Lëndë bazë	5-10%	8.3%	2	10
B	Lëndë karakterizuese	50-60%	54.1%	9	65
C	Lëndë ndërdisip/ Integruese	12-20%	12.5%	4	15
D	Lëndë plotësuese	10%	10%	2	12
E	Detyrime përmbyllëse	10-15%	15%	1	18

	<p><i>(Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2019-2021 dhe 2020-2022- dokumentacion shitesë në e-ascal)</i></p> <p>GVJ vëren se në planet mësimore të vëna në dispozicion dhe të marra në analizë më sipër 2019-2021, 2020-2022, 2022-2024, duhet riparë përkatësia e lëndëve të komponentit mësimor të kategorisë A dhe C pasi rezulton se “Kërkimi sasior dhe cilësor në Psikologjinë e edukimit” si dhe lënda “Vlerësimi zhvillimor dhe testet e matjes”, janë kategorizuar si komponentë mësimorë të kategorisë C, në një kohë kur VKM 41 e përcakton qartë se komponenti mësimor përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme është i kategorisë A. Lëndët e përcaktuara nën kategorinë A mund të inkuadrohen si lëndë integruese/ ndërdisiplinore.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në Kornizën konceptuale të programit të studimit MSc PE., pika I. Parimet dhe kërkesat e programit deklarohet se: “Hartimi i programit përmban një kurrikul të pasur si në aspektin teorik dhe në atë praktik. Programi, syllabuset e lëndëve dokumenta të ndryshme që ky program përmban bazohen në parime të përgjithshme të zhvillimit të arsimit, cilesisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.”</p> <p>Sipas objektivave të programit të studimit MSc. PE synohet të ofrohen njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike mbi rolin dhe rëndesinë e psikologut në përgjithësi dhe të psikologut të edukimit në veçanti. Programi synon të përgatisë profesionistë, të cilët mund të angazhohen apo punësohen sipas kërkesave të tregut të punës në: - Institucione publike dhe private - Organizata të Shoqërisë Civile - Eksperte të pavarur.</p> <p>Në dokumentin e Kornizës konceptuale parashtrohen objektivat kryesore të programit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- pajisja me njohuri mbi zhvillimin e psikologjisë dhe figura të shquara të psikologut shkollor, 2- pajisja me dije të avancuara në teoritë dhe konceptet kryesore psikologjike, 3- pajisja me aftësi për të kuptuar rolin dhe funksionin e psikologut në shoqëri dhe institucione të ndryshme, veçabërisht në shkolla, 4- pajisja me aftësi për të organizuar shërbimin psikologjik në insitucion arsimore, 5- pajisja me aftësi për ndërhyrj në praktikën e përditshme mbi sjelljet problematike problemeve psikologjike, emocionale etj, të nxenesve, femijeve, individeve në insitucion
	<p>Në prioritetin strategjik nr.1 në Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit: Mësimdhënia dhe zhvillimi i kurrikulës shprehet qartë fokusi i DP për nxitjen e mendimit kritik, inovativ me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire që karakterizohet nga</p>

	<p>debati i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj mirëqënies dhe respektimit të së mirës private dhe publike. Departamenti i Psikologjisë synon që përmes programeve të studimit t'i orientoje studentët drejt të menduarit analitik dhe ndërdisiplinor dhe t'i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës. Studentëve, krahas njohurive në disiplinën karakterizuese të studimit ju ofrohen dije dhe kompetenca edhe në disiplina të përfaqëta duke synuar kultivimin e kompetencave të nevojshme për të përgatitur profesionistë të specializuar në shërbim të komunitetit.</p> <p>Edhe në planin mësimor të programit të studimit konstatohet ndërthurja e lëndëve të profilit karakterizues (psikologji edukimi e aplikuar, psikologji sociale e aplikuar në komunitet dhe familje, terapi dhe këshillim psiko-edukativ, intervenim i hershëm përmes lojës, psikologji shëndeti dhe rehabilitimi në shkollë, vlersësimi dhe ndërhyrj në kriza dhe trauma, nxënësimi me nevoja të veçanta-tratimi psiko-edukativ, autizmi dhe trajtimi psiko-edukativ) me lëndë të profilit metodologjik kulturë e përgjithshme e lëndë ndërdisiplinare.</p> <p><i>(2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit; 1.19 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Aneksat e RVB-tabela 9, tabela 10; Plani mesimor Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022, 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit të studimit rezulton se në programin e studimit MSc. PE ka të përcaktuara në dispozicion të praktikës 14 kredite në planin mësimor 2019-2021, 2020-2021 (në mungesë përputhshmërie me VKM 41, shih standartin II.1. kriteri 1.) dhe në planin mësimor për ciklin e studimit 2022-2024 ka të përcaktuara në dispozicion të praktikës 12 kredite (në përputhje me VKM 41, shih standartin II.1. kriteri 1.)</p> <p>Në planin mësimor për ciklin e studimeve 2019-2021, 2020-2021 në funksion të detyrimeve përmbyllëse janë përcaktuar 20 kredite (në mungesë përputhshmërie me VKM 41, shih standartin II.1. kriteri 1.) dhe në planin mësimor për ciklin e studimit 2022-2024 ka të përcaktuara në dispozicion detyrimeve përmbyllëse 18 kredite (në përputhje me VKM 41, shih standartin II.1. kriteri 1.)</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 9, tabela 10; Plani mesimor Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022, 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit MSc. PE.</p>

ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit MSc. PE.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë Kreu III, Seksioni I, Neni 17: Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë, pika 5 përcaktohet se: “Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, gëzojnë status të veçantë. Ky status i jepet institucionit të arsimit të lartë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.” Sipas këtij përcaktimi, Universiteti i Elbasanit nuk është Institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga vizitat në Institucion në data 14-15 dhjetor 2022, GVB deklaroi se program i studimit Msc. PE ofrohet vetëm nga UE. Edhe nga kërkimi i Gvj rezulton se program i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Psikologji edukimi” nuk ka ngjashmëri në emërtesë me ndonjë program tjetër studimi të së njëjtës fushë dhe të të njëjtit nivel studimi.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në Udhëzimin Nr. 31, datë 15.11.2022 për “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, pika 12 theksohet se: “Për programet e studimit ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre brenda muajit Mars 2023”.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Në Statutin e UE, Strategjinë e zhvillimit Institucional të UE dhe në Rregulloren e studimeve të UE parashikohet edhe rëndësia e programeve të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në nenin 55 Të Statutit të UE në lidhje me Programet e përbashkëta të studimit parashikohet: 1. UE është i hapur për të realizuar programe të përbashkëta studimi në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.

	<p>2. Procesi i realizimit të programeve të përbashketa realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit.</p> <p>3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.</p> <p>Programi i Studimit MSc. PE nuk është një program i përbashkët studimi. (1.1. Statuti i UNIEL; 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; 1.3 Strategjia e UNIEL)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se në përgjithësi programi i studimit “Master i shkencave” në “Psikologji edukimi” organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit vihet re se elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë në përputhje me VKM 41, veprimtaritë formuese janë të organizuara sipas kategorive të VKM 41 dhe të të vlerësuara në kredite, sipas Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Gjithashtu, programi i studimit nën vlerësim siguron formimin e shprehive të veçanta dhe të përgjithshme në lidhje me fushën e studimit dhe të orientuar drejt sektorit të punësimit. Studentët që ndjekin programin e studimit pajisen me aftësi për të të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushën e psikologjisë së edukimit, të cilat do ju shërbejnë në praktikën e punës dhe për zgjidhjen e problemeve të ndryshme gjatë ushtrimit të profesionit.</i></p> <p><i>GVJ vëren se që prej hyrjes në fuqi të VKM 41 në Janar të vitit 2018 e deri në vitin akademik 2022-2023, DP:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1- Nuk ka patur bërë ndryshimet e nevojshme në planin mësimor të programit të studimit për përputhjen e peshës specifike të kategorive të veprimtarive formuese dhe të përbashkëpunimit të komponentit mësimor të kategorisë A dhe C (plani mësimor 2019-2021, 2020-2022).</i> <i>2- Në planin mësimor të programit të studimit për ciklin e studimit 2022-2024 është realizuar përputhja e peshës specifike të kategorive të veprimtarive formuese me VKM 41, edhe pse në programin e studimeve Msc. PE për vitin akademik 2022-2023 nuk ka studentë të rregjistruar në vitin e parë. E megjithatë, sygjerojmë që DP të rikonsiderojë përkatësinë e lëndëve të komponentit mësimor të kategorisë A dhe C.</i> <i>3- Në planet mësimore të vëna në dispozicion dhe të marra në analizë më sipër 2019-2021, 2020-2022 rezulton se në programin e studimit MSc. PE ka të përcaktuara në dispozicion të praktikës 14 kredite dhe në dispozicion të detyrimeve përmbyllëse janë përcaktuar 20 kredite sipas planeve mësimore</i>

	<i>për ciklin e studimeve 2019-2021, 2020-2021 (në mungesë përputhshmërie me VKM 41). Në planin mësimor për ciklin e studimit 2022-2024 ka të përcaktuara në dispozicion të praktikës 12 kredite dhe në dispozicion të detyrimeve përmbyllëse 18 kredite (në përputhje me VKM 41.)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Në përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë përcaktohen qartë detyrimet e njësive kryesore dhe njësive bazë në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike si më poshtë vijon:</p> <p>Në Nenin 23 të Ligjit përcaktohet se: “Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. ...Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente. ...Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë”.</p> <p>Në Nenin 25 të ligjit përcaktohet se Departamenti: “Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. ...Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.”</p> <p>Bazuar në përcaktimet e mësipërmë GVJ konstaton se njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit MSc. PE, Fakulteti i Shkencave të Edukimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe përmban në strukturën e tij 4 njësi bazë (Departamente) dhe një Qëndër. Në këtë fakultet ofrohen kryesisht programe studimi të shkencave të edukimit dhe programe të ndërlidhura me edukimin. Struktura e Fakultetit përcaktohet në Statutin e UE, kreu II, neni 5 dhe neni 7 dhe Kreu III. Nga të dhënat më të fundit të organigramës së FSHE për vitin akademik 2022-2023 rezulton se FSHE ka në përbërjen e tij 37 personel</p>

akademik me kohë të plotë, prej të cilëve: 3 të kategorisë Prof. Dr.; 14 të kategorisë Prof. Asoc.; 15 të kategorisë Dr.; 4 të kategorisë Doc. Dr.; 1 të kategorisë MSc.

FSHE ka në strukturën e tij personel ndihmës akademik-laborante (3-tre) dhe 1 (një) personel ndihmës akademik-specialiste; gjithashtu 4 punonjës të kategorisë personel ndihmës akademik me karakter administrative.

Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit, Departamenti i Psikologjisë rezulton se ka 7 personel akademik të angazhuar me kohë të plotë (PAE) dhe 12 personel akademik me kontratë (PAK). Nga PAE në DP rezulton se: 1 pedagog është i kategorisë Prof. Dr.; 2 pedagogë janë të kategorisë Prof. Asoc.; 4 pedagogë janë të kategorisë Dr. Nga PAK në DP rezulton se: 2 pedagogë janë të kategorisë Dr dhe 10 janë të kategorisë Msc. Angazhimi i personelit akademik sipas kategorisë në programin e studimit MSc. PE është si më poshtë vijon:

Viti akademik 2019-2020-MSc. PE

PAE DP	6	1 Prof. Dr. 2 Prof. Asoc. 3 Dr.	Numri i personelit PAK	Grada tituj
PAE Njësi të tjera	2	1 Prof. Dr. 1 Dr.	3	1 Dr. 2 Msc,

Viti akademik 2020-2021-MSc. PE


PAE DP	6	1 Prof. Dr. 2 Prof. Asoc. 3 Dr.	Numri i personelit PAK	Grada tituj
PAE Njësi të tjera	2	1 Prof. Dr. 1 Dr.	3	1 Dr. 2 Msc,

Viti akademik 2021-2022-MSc. PE

PAE DP	5	2 Prof. Asoc. 3 Dr.	Numri i personelit PAK	Grada tituj
PAE Njësi të tjera	2	1 Prof. Dr. 1 Dr.	6	2 Dr. 4 Msc,

Viti akademik 2022-2023 -MSc. PE (vetëm viti II aktiv)

PAE DP	4	2 Prof. Asoc. 2 Dr.	Numri i personelit PAK	Grada tituj
PAE Njësi të tjera	1	1 Dr.	4	1 Dr. 3 Msc,



	<p><i>(1.1. Statuti i UNIEL e-ascal- Organigrama e FSHE, 1.11 Struktura organizative e UNIEL, Aneksat e RVB-tabela 2, 2.16. CV e personelit akademik dhe ndihmesakademik per programin e studimit, Aneksat e RVB-tabelat 12¹-12⁴).</i></p> <p>Departamenti i Psikologjisë është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe ofron programe studimi në fusha kërkimi të përafërta. DP është përgjegjës për 3 programe studimi (një program bachelor, një program master i shkencave dhe një program studimi master profesional) veprimtaria mësimore dhe kërkimore-shkencore e të cilëve është në administrim të tij.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 3).</i></p> <p>Njësia kryesore dhe njësia bazë e ofrimit të programit të studimit Msc. PE në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, Kreu X: Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, Neni 106: Akreditimi ju nënshtrohen proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të vlerësimit të jashtëm në mënyrë periodike dhe e dokumentojnë këtë proces në forma të ndryshme të raporteve.</p> <p><i>(3.15 Raport vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, 4.18 Raport per veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021, e-ascal: Çertifikata e akreditimit Institucional)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Programi i studimit Msc. PE ofruar nga Departamenti i Psikologjisë në planin e tij mësimor ka të paraprirë zhvillimin e praktikës institucionale në të dyja vitet e studimit. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel akademik efektiv për realizimin e praktikave institucionale. Praktikë institucionale janë të rregulluara gjithashtu nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione me fushë veprimi në dobi të programit të studimit dhe modalitetet e vlerësimit gjatë praktikës janë përcaktuar në programin e kursës hartuar nga drejtuesja e praktikës caktuar nga departamenti.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 5, 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave, 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, Aneksat e RVB-tabela 10, 2.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave</p>	<p>Në rregulloren e departamentit të Psikologjisë në nenin 11 të saj parashikohen përgjegjësitë e koordinatorëve të programeve të studimeve që ofrohen nga DP. Roli qëndror i koordinatorit të programit të studimit është të sigurojë dhe të kooordinojë ndërveprimin për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>



profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Psikologjisë me anë të një vendimi të posaçëm ka caktuar sipas rregullore së departamentit koordinatoret e programeve të studimit që ofrohen në DP, ndër ta edhe koordinatori i programit të studimit “Master i shkencave: në “Psikologji Edukimi”. <i>(1.17 Rregullore e Departamentit, 2.10 Vendim për përcaktimin e koordinatorit të programit të studimit)</i>			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë si njësi përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit programin e studimit “Master i shkencave: në “Psikologji Edukimi” përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, caktimin e një koordinatori për programin e studimit në funksion të realizimit të objektivave të tij dhe të drejtimit të praktikave profesionale nga personel akademik. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka të miratuar me vendim Senati Nr.03, datë 28.01.2020 “Rregulloren e studimeve në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” me objekt të saj (neni 1) përcaktimin e rregullave, procedurave, detyrave, përgjegjësisive lidhur me realizimin e studimeve në UE. Sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje efektet e saj shtrihen mbi personelin akademik, ndihmësakademik, administrative, si dhe studentët e UE-së. Të gjitha njësitë e UE-së, duhet të harmonizojnë rregulloret e tyre si dhe veprimtarinë në përputhje me këtë rregullore. Njësia kryesore e FSHE në zbatim të nenit 2 ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e studimeve në FSHE”, miratuar me Vendim Senati Nr. 21, datë 5.4.2020. Në këtë rregullore vihen në dispozicion informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit që ofrohen në FSHE. Në nenin 3 të saj (në përputhje me Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar) parashikohet se: “Çdo program studimi në FSHE ka rregulloren e tij. Rregullorja e programit të studimit hartohet nga departamenti përgjegjës për programin e studimit dhe miratohet në Senatin Akademik me programin përkatës të studimit”.

	<p>Rregullorja e programit të Studimit MSc.PE rezulton të jetë miratuar në vitin 2022 me objekt (neni 1) “Të vendosë rregullat normative të funksionimit të programit dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e këtij Niveli Studimi. Rregullorja përcakton misionin e MSC per PE, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të saj, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkepunëtorëve; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kerkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikime, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores”.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit është përcaktuar si një nga dokumentet bazë të programit të studimit në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Gjithashtu, edhe nga aktet e brendshme rregullatore të UE dhe FSHE sipërcituar mbi studimet përcaktohet detyrimi i njësisë bazë për përshtatjen e rregullores së programit të studimit me aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret e institucionit.</p> <p>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit MSC. PE është një dokument i përshtatshëm për të orientuar informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit për aktorët e përfshirë në këtë program studimi.</p> <p><i>(1.20 Rregullore e programit të studimit, 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; Rregullore e studimeve ne FSHE- dokumentacion shtesë në e-ascal, Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p> <p>Nga elementët e programit të studimit të përcaktuara në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar rezulton se Plani mesimor i programit të studimit është një dokument informues cilësor mbi strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mesimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mesimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit MSC PE përmban planin mesimor sipas përcaktimeve të Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mesimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor /jashtë auditorit.</p> <p>Nga analiza e planit mesimor rezulton se programi i studimit MSc. PE është organizuar në 4 semestra, me një total prej 120 kreditesh. Në vit të parë realizohen 9 lëndë, secila me peshën të shprehur në orë dhe në kredite përkatëse, me një ngarkesë totale prej 60 kredite. Në vitin e dytë gjithashtu, realizohen 9 lëndë secila me peshën të shprehur në orë dhe në kredite përkatëse, me një ngarkesë totale prej 60 kreditesh. Totali i orëve mesimore vjetore është 1500 orë. Orët mesimore organizohen në orë në auditor (leksione, seminare, laborator) dhe në orë studimi individual.</p>

	<p>GVJ konstaton se praktika profesionale është shpërndarë në planin mësimor në vitin e parë me ngarkesë javore 2 orë, dhe në vitin e dytë me ngarkesë javore 4 orë. Në çdo rast kjo shpërndarje në planin mësimor bie ndesh me Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” pika II.12 e) sipas të cilit një ditë pune në praktikë është 5 orëshe.</p> <p><i>(Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga elementët e programit të studimit të përcaktuara në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, kreu IV A, pika 5, Kreu IV B, pika 3 dhe VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, programi i studimit në rregulloren e Programit të studimit duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Rregullorja e Programit të studimit MSc. PE. (2022) përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>(1.20 Rregullore e programit të studimit)</i></p> <p>Nga sa më sipër GVJ vëren se Kushtet e pranimit janë të mirë informuara dhe të orientuara edhe në dokumentin orientues plotësues “Korniza Konceptuale e studimit”, ku shprehet edhe kërkesa mbi gjuhën e huaj si dhe detyrimi për përfundimin e studimeve të ciklit të parë në “Psikologji”.</p> <p><i>(pika IV. Kushtet e pranimit)</i></p> <p>Nën konstatimet e mësipërme të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve orientohen edhe nëpërmjet dokumentave themelore si rregullore e studimeve në UE dhe rregulloren e studimeve në FSHE. Gjithashtu, nga Vizita në institucion GVJ u informua se kriteret e pranimit bëhen publike në faqet zyrtare të FSHE dhe UE.</p> <p><i>(1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; Rregullore e studimeve ne FSHE- dokumentacion shtesë në e-ascal, 2.15 Korniza konceptuale e programit te studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë dëshmon nëpërmjet dokumentacionit shoqërues të RVB-së se mban në mënyrë sistematike dosjen e programit të studimit MSc. PE në të cilën gjenden informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë dhe për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me VKM 41, të ndryshuar.</p> <p><i>(Anekset e RVB-tabela 10, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>

<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të planeve mësimore të vëna në dispozicion nga DP konstaton se Plani mësimor nuk ka ndryshuar në përmbajtje të tij në asnjërin prej planeve mësimore në administrim për ciklet e studimeve 2019-2021, 2020-2022, 2022-2024. Edhe gjatë vizitës në institucion u pohua që përmbajtja e planit mësimor nuk ka pësuar ndryshime. Megjithëse gjatë vizitës nga GVJ u kërkua procedura e fundit e ndryshimit të përmbajtjes së planit mësimor të programit të studimit (meqënëse është një program në akreditim për herë të parë) ajo nuk u vu në dispozicion edhe në fazën e dytë të depozitimit të dokumentacionit në E-ascal pas vizitës në institucion.</p> <p>Ndryshimi i përmbajtjes së programit të studimit gjatë takimeve në institucion me GVB u adresua për evidentim tek syllabuset e lëndëve dhe ndryshimet në përmbajtjen e tyre në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>GVJ konstaton se edhe në syllabuset e lëndëve të vëna në dispozicion praktikat e ndryshimit për vitet e depozitimit të dokumentacionit janë të pjesshme si në përmbajtje, ashtu edhe në propozim literature. GVJ konstaton se edhe pse është një objektiv Strategjik i shprehur në strategjinë zhvillimit të departamentit dhe Strategjinë e zhillimit të programit të studimit ndryshimi dhe përditësimi i Kurrikulës për periudhën në akreditim nuk evidentohet.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 10, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, Plani mesimor_ Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p> <p>Departamenti i Psikologjisë dëshmon se në fillim të vitit akademik arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. Në gjuhën angleze depozitohen dokumenta si: plani mësimor i programit të studimit, suplementi i diplomës, rregullore e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, dokumenti informues i kornizës konceptuale.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe praktikave të evidentuara gjatë vizitave në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë si njësi përgjegjëse bazë për ofrimin e programit të studimit MSC. PE përmbush kryesisht standartin mbi elementët e programit të studimit, të cilët transmetojnë informacion mbi përmbajtjen, organizimin, kriteret e pranimit dhe strukturën tek aktorët që ndërveprojnë në këtë program studimi.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që DP lipset të konsiderojë përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme sipas objektivave strategjike të zhvillimit të departamentit dhe programit të studimit. Gjithashtu, DP sugjerohet të rishikojë shpërndarjen e praktikave profesionale në planin mësimor në vitin e parë me ngarkesë javore 2 orë, dhe në vitin e dytë me ngarkesë javore 4 orë. Shpërndarja aktuale bie ndesh me Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në</i></p>

	<i>institucionet e arsimit të lartë” pika II.12 e) sipas të cilit një ditë pune në praktikë është 5 orëshe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ pas njohjes me planin mësimor të programit të studimit, programet lëndore sipas tipeve të veprimtarive konstaton se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive dhe praktikave mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për tu specializuar si një ekspert në psikologjinë e edukimit. Në përfundim të studimeve, bazuar edhe tek Korniza Konceptuale e programit të studimit, të diplomuarit do jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të jenë kompetentë në përdorimin e metodave dhe instrumentet e kërkimit psikologjik; - të jenë të aftë të konceptojnë, ndërtojnë dhe zbatojnë një kërkim shkencor; - të zotërojnë dije dhe njohuri mbi teoritë dhe paradigmat bashkëkohore psikologjike; - të zhvillojnë analiza teorike dhe praktike të dukurive dhe problemeve psikologjike, emocionale, psiko-sociale të fëmijëve dhe adoleshentëve; - të punojnë në grup dhe të ndërtojnë marrëdhënie me ekipe multidisiplinare; - Të shfaqin standarte të larta etike dhe formimi psikologjik për të zhvilluar me dinjitet profesionin dhe aktivitetin e tyre në shoqëri. <p>Këto aftësi do të bëjnë të mundur orientimin e studentëve drejt tregut të punës si psikologë, por do të mundësojnë edhe orientimin e tyre drejt studimeve të thelluara të ciklit të tretë të studimeve Master Ekzekutiv ose studimeve doktorale.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 10, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, Plani mesimor_ Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal; 2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit MSc PE është i organizuar në 15 lënde dhe module lëndore, praktikë në institucione të shtrirë në të dyja vitet akademike dhe nga punimi i diplomës si detyrim përmbyllës i ciklit</p>

<p>objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>të studimeve. Në mbërritje të objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të të mësuarit dhe kërkimit shkencor në fushë dija është ndërtuar në koherencë logjike duke filluar me lëndë të fromimit të përgjithshëm dhe në mënyrë të gradualshme, duke ndërtuar dijen semestër pas semestri në lëndët e formimit të specializuar dhe duke identifikuar në lëndët e karakterit ndërdisiplinar rëndësinë e ndërveprimit ndëpërmjet njohjes së dijeve të disiplinave të tjera sociale dhe të edukimit.</p> <p><i>(Aneksat e RVB-tabela 9, tabela 10; Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal; 2.15 Korniza konceptuale e programit te studimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Në strukturën e programit të studimit lëndët organizohen sipas tipeve të veprimtrive formuese dhe orët mësimore të tyre ndahen në orë teorike të organizuara kryesisht në lëksione dhe seminare dhe orë praktike të organizuara kryesisht si orë laborator. Zakonisht më shumë se gjysma e orëve mësimore të një lënde i dedikohet punës së pavarur të studentit sipas përcaktimeve të VKM 41. GVJ vlerëson se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare si për shembull në Bristol University, University of York, etj.</p> <p><i>(Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal; 2.15 Korniza konceptuale e programit te studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtrive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MSC. PE është i organizuar në lëndë dhe module sipas veprimtrive formuese, në orë teorike dhe praktike që mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe në të cilin lëndët janë të vlerësuara sipas "Sistemit Evropian te Transferimit dhe Grumbullimit te Krediteve" (ECTS) duke mundësuar transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve.</p> <p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe vizita në institucion rezulton se në programin e studimi MSC. PE nuk ka patur transferime studimesh për periudhën 2020-2022 dhe as studentë, të cilët kanë kryer programe mobiliteti. Gjatë vizitës në institucion, studentët identifikuan kushte të tyre objective personale që i pengonin të bëheshin pjesë e programeve të mobilitetit, pavarësisht nxitjes së vazhdueshme nga personeli akademik dhe thirrjeve të hapura për aplikim nga UE.</p> <p><i>(Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal; 2.15 Korniza konceptuale e programit te studimit; 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+, 3.2 Të dhëna për mobilitetin FSHE)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit të Psikologjisë, neni 11: përgjegjësitë e koordinatorëve, pika 9 parashikohet se: “Koordinatori i programit në bashkëpunim me titullarët e lëndëve është përgjegjës për përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të programit të studimit, duke u bazuar në</p>

<p>punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>literaturën e detyruar dhe ndihmëse të pesë viteve të fundit”. Sikurse u argumentua në standartin II.3, kriteri 5, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve në përmbajtjen e tyre synojnë marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, por nga syllabuset e vëna në dispozicion praktikantët e ndryshimit për vitet e depozitimit të dokumentacionit janë të pjesshme si në përmbajtje, ashtu edhe në propozim literaturë bazë dhe ndihmëse.</p> <p><i>(1.17 Rregullore e departamentit; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Në analizë të gjithë dosjes së programit të studimit, GVJ konkludon se përmbajtja e programit të studimit Msc. Në “Psikologji edukimi” garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p><i>(1.20. Rregullore e programit të studimit; 2.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve; Plani mesimor_Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal; 2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Sipas pikës VIII të kornizës konceptuale studentët që diplomohen në programin e studimit MSc. PE pas studimeve mund të punësohen si: Psikologë në shkollë, ekspertë në projekte kërkimore dhe praktike, drejtues kërkimi, analist politikash, vlerësues programesh, koordinatorë programesh dhe projektesh të ndryshme psiko-edukative, menaxherë të burimeve njerëzore, ofrues të shërbimit psiko-social, si këshillues, në shërbimet ndaj studentëve, etj., mundësi avancimi në karrierë akademike dhe mundësi për të kryer studime të ciklit të tretë në të ciklit të tretë dhe programe doktorale brenda dhe jashtë vendit në fushën e Psikologjisë.</p> <p>Tregu i synuar i punës për psikologun e edukimit është një treg i rregulluar bazuar në Ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 40/2016 për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë.</p> <p><i>(2.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve; Plani mesimor_Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal; 2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se përgjithësisht struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të mësuarit dhe “paketës” së kompetencave që e bëjnë programin e studimit të jëtë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>GVJ sugjeron të rishikohet me prioritet përditësimi në mënyrë të vazhdueshme i syllabuseve të lëndëve dhe moduleve lëndore me synim përshtatjen e përmbajtjes së tyre në funksion të kërkesave të reja të kompetencave për të maksimizuar ofertën me kërkesën e tregut të punës,</p>



	<i>si dhe duke përditësuar aty ku është e mundur duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse me literaturë të viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstaton se në praktikën e DP hapësirat më të rëndësishme dedikuar analizës SWOT të programeve të studimit janë analizat vjetore të punës dhe raportet e vetëvlerësimit për programet e studimit.</p> <p>Gjithashtu, gjatë takimeve në institucion GVJ evidenton se DP mban takime periodike me aktorë të ndryshëm të përfshirë në realizimin e programit të studimit si: personeli akademik me kohë të pjesshme, rrjeti ALUMNI, institucionet partnere të praktikave dhe aktorë të tjerë të tregut të punës. Drejtoria Juridike, Këshillimit të karrierës dhe ALUMNI, Sektori i këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI gjatë vizitave në institucion dëshmoi se mban në mënyrë të vazhdueshme kontakte me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës dhe të diplomuarit, sugjerimet dhe reflektimet e të cilëve i shpërndan më njësinë bazë për të reflektuar në përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>(3.15 Raport vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, 4.18 Raport per veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, 1.11 Struktura organizative e UNIEL, Aneks RVB-tabela 5; EVIDENCA 5.6 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me studentë të programit të studimit MSc. PE gjatë vizitës në institucion në datën 14.12.2022, GVJ konstaton se studentët mbajnë kontakte të rregullta me departamentin e psikologjisë dhe kanë hapësirat e tyre të shprehjes së mendimeve rreth kurrikulës së programit të studimit, programeve lëndore dhe formave të vlerësimit. Departamenti i Psikologjisë nxit përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve për t'u angazhuar në dhënien e sugjerimeve që do të përmirësonin ofertën akademike të programit të studimit. Provë e përfshirjes së të diplomuarve është edhe lista e personelit akademik me kohë të pjesshme, e cila në një peshë specifike të rëndësishme përfshin ish-studentë të Departamentit të Psikologjisë.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion, 14.12.2022; 3.15 Raport vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, 4.18 Raport per veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, 1.21 Analiza vjetore e</i></p>


	<i>departamentit 19-22, 2.16. CV e personelit akademik dhe ndihmesakademik per programin e studimit)</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Programi i studimit MSC. PE është një program i ciklit të dytë të studimeve në fushën e Psikologjisë. Profesionit i psikologut është në listën e profesioneve të rregulluara dhe rregullohet nëpërmjet Urdhrit të Psikologut.</p> <p>GVJ sugjeron se njësia përgjegjëse lipset të ri-inkuadrojë paketën e dokumenteve të programit të studimit MSC. PE, duke konsideruar Ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 40/2016 për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Sugjerojmë se këto baza ligjore të referohen dhe konsiderohen me kujdes në punën e DP, duke u reflektuar në rregulloren e Departamentit të Psikologjisë, në Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit, në strategjinë e programit të studimit dhe strategjitë e zhvillimit të programeve të tjera të ofruara në këtë departament, pasi lidhen drejt për së drejti me përshtatjen dhe harmonizimin e programeve të studimit me aktet ligjore në fuqi dhe ndihmon në harmonizimin e ofertës së programeve të studimit me kërkesat e tregut.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vëren se Departamenti i Psikologjisë dhe UE nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, në diskutime me studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit dhe programeve lëndore, dhe i reflekton ato kur janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron konsiderim të kujdesshëm të akteve rregullative mbi profesionet e rregulluara dhe ligjit mbi Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në dokumenta themelore të programit të studimit dhe të Departamentit të Psikologjisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>GVJ konstaton se në strategjinë e programit të studimit MSc. PE përcaktohen qartë objektivat dhe prioritetet kryesorë të studimit dhe të kërkimit shkencor. Në pikën II. Misioni dhe Vizioni të strategjisë evidentohen disa nga objektivat kryesorë të programit të studimit që synojnë:</p> <p>1- Përmirësimin e kurrikulës ekzistuese të programit të studimit sipas kërkesave dhe zhvillimeve të reja shoqërore dhe tregut të</p>

	<p>punës, duke përshtatur programin e studimit me risitë teorike dhe praktike në fushën e psikologjisë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2- Rritjen e vëmendjes në zhvillimin e kërkimit shkencor duke nxitur sa më shumë studime të lidhura me aspekte psikologjike dhe psiko-sociale. 3- Formimin e specialistëve të lartë në fushën e psikologjisë së edukimit dhe në përputhje me zhvillimin e vendit. 4- Krijimin e një ambienti inkurajues dhe motivues për kërkimin shkencor mbi psikologjinë dhe psikologjinë e edukimit në veçanti. Integrimin e gjetjeve të kërkimit shkencor në mësimdhënie. 5- Arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përkrahjen e aspiratave dhe arritjeve të cilatdo që kërkon të përfitojë dije psikologjike. <p>Dy nga prioritetet strategjike të zhvillimit të programit të studimit MSc. PE., pika III janë: Prioriteti nr. 1: Mësimdhënia dhe zhvillimi i kurrikulës; Prioriteti nr. 2: Kërkimi shkencor. Këto prioritete janë në përputhje të plotë me objektivat strategjike të UE shprehur në pikën 1 të Startegjisë së zhvillimit të UE, në pikën 1.2. Kurrikula dhe në pikën 1.4. Ndërkombëtarizimi.</p> <p><i>(1.19 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; 1.3 Strategjia e UNIEL)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregullore të programit të studimit MSc. PE, në nenin 8. Parimet deklarohet se: “MSC-ja për PE e zhvillon veprimtarinë në bazë të parimeve: të lirisë akademike, të autonomisë institucionale, të cilesisë, të efektshmerisë, të efijencës.”</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Në kuadër të lirisë akademike, gjatë veprimtarisë së MSc. PE veprimtaria akademike e programit të studimit MSc. PE nuk i nënshtrohet ndërhyrjeve nga jashtë, censurës dhe barrierave të llojeve të ndryshme. 2- Në kuadër të autonomisë institucionale, FSHE e MSC për PE: a) miraton vetë strategjinë e zhvillimit b) miraton vetë dhe në Senatit Akademik të UE-së programet mësimore; c) ngre këshilla dhe komisione për realizimin e misionit të saj; d) ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare të fushës së studimeve shkollore; e) ka të drejtë të bashkëpunojë me fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë në fushën e studimeve mbi psikologjinë e edukimit dhe në procesin e integritit europian të shkollës shqiptare; f) ka të drejtën e përzgjedhjes së personelit akademik dhe jo akademik; g) ka të drejtën e përdorimit të ndërtesave dhe të pasurive të tjera të dhëna nga Universiteti i Elbasanit ose dhurues të ndryshëm sipas legjislacionit në fuqi. <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe praktikave të punës të prezantuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se FSHE dhe DP nxisin,</p>



	<p>bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> <p><i>(1.20. Rregullore e programit të studimit, neni 8: Parimet; informacion nga vizita në institucion, 14-15.12.2022)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Përgjatë veprimtarisë akademike të programit të studimit MSc. PE, studentët kanë një vëmendje të dedikuar që është shprehje e prioriteteve të Universitetit të Elbasanit, Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe të punës së përditshme të Departamentit të Psikologjisë. UE ka mbajtur Konferencën e parë ndërkombëtare studentore “Shkenca e hapur dhe ndërkombëtarizimi”, 29 prill 2022. Departamenti i Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit ka mbajtur Konferencën shkencore studentore “Impakti i E-learning në performancën psikopedagogjike”, 2 shkurt 2021.</p> <p>Gjithashtu, studnetët nxiten dhe motivohen për të qënë pjesë aktive e trajnimeve dhe projekteve të ndryshme me fokus studentët. Ndër të tilla aktivitete mund të përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Trajnime: “Si të luftojmë dezinfomimin”; Seancë trajnimi me profesorë të Humboldt-Universitāt zu Berlin; “Integrimi i studentëve në tregun e punës”; etj 2- Projekte: “Klubi i Debatit”; Projekti ‘Përtej Gardheve 2’, “Akademia e medias”, etj. <p><i>(1.10 Lista e trajnimit të studentëve; 3.13 Konferenca studentore UE, 3.14 Konferenca studentore AU UFO, 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22; 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Aneksë RVB-tabela 19; 4.18 Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik)</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GJV konstaton se njësia bazë e Departamentit të psikologjisë mbështetet financiarisht nga institucioni për realizimin e veprimtarive studimore, kërkimore e shkencore në forma të ndryshme, si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Publikimi pa pagesë në revistën shkencore BULETINI për personelin akademik dhe studentët. Botimi i revistës financohet nga UE. 2- Mbështetja financiare në realizimin e konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare, duke mbuluar konstat administrative dhe konstat e botimit të paketës së dokumentave të konferencës për pjesëmarrësit. 3- UE me propozime të njësisë bazë mbështet financiarisht pasurimi ne fondit ë librave dedikuar profilit të studimeve psikologjike në mbështetje të veprimtarisë studimore të programit të studimit MSC. PE si dhe Departamentit të Psikologjisë. 4- UE nëpërmjet politikave të saj siguron akses në library online dhe në platforma digjitale literature si JSTOR, U-Library, etj.

	(2.3 Miratimi i Buxhetit 2022; 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022; 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL; 2.7 Anëtarësimi në JSTOR dhe U-Library; 2.8 Fondi i librit; Aneks RVB-tabela 17)			
Konkluzione	Në përfundim të analizës së kriterëve të standartit II.6, GVJ konkludon se Departamenti i Psikologjisë që ofron programin e studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji Edukimi” garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, duke siguruar lirinë akademike, autonominë, mbështetjen e duhur për realizimin e objektivave të studimit, kërkimit shkencor dhe mbështetjen për realizimin e prioriteteve strategjike të programit të studimit mbi studimet, kërkimin shkencor dhe mbështetjen e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ konstaton se zhvillimi i partneriteteve për të realizuar veprimtari kërkimore shkencore të përbashkëta është në fokus të prioriteteve strategjike të UE, FSHE dhe DP. Në gjithë hierarkinë e strukturave të UE dëshmoheq qartë fryma e bashkëpunimit. Edhe FSHE/ DP si njësia Kryesore dhe njësia bazë e ofrimit të programit të studimit MSC. PE mbështesin grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe sigurojnë bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Në realizimin e veprimtarive me karakter kërkimor shkencor vihen re bashkëpunime të konsoliduara me: Universitetin “Aldo Moro”, Bari; Universitetin “Cote d’Azur; Univerisiteti i Universiteti i Bolonjës “Alma Mater Studiorum”; Universiteti i studimeve të Aquila-s; Universiteti i Foggias; etj. Gjithashtu DP dëshmon për bashkëpunime të konsoliduara në fushën e kërkimit shkencor edhe me institucione kërkimore vendase dhe të rajonit si psh: Universitetin e Tiranës, Universitetin “Luigj Gurakuqi”; Universitetin e Prishtinës; Albanian University, Kollegjin AAB, Universitetin e Tetovës, etj. (1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; 3.12 Konferenca e departamentit Qershor 2022, 3.13 Konferenca studentore UE, 3.14 Konferenca studentore AU UFO, 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021, Aneks RVB-tabela 19)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc. PE dhe Departamenti i Psikologjisë rezultojn të jenë të angazhuar në përgjigjen e kërkesave të aktorëve të tjerë për analiza, kërkime, studime e projekte

<p>akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>kërkimore shkencore në të cilin angazhojnë edhe studentë. Nga të dhënat rezultojnë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv për programin e studimit është 30; 2- Numri i projekteve kërkimore të fituara nga Departamenti/ FSHE me drejtues projekti personel akademik nga DP rezultojnë të jetë 1 (një); 3- Numri i projekteve të zbatuara në rang Departamenti rezultojnë të jetë 1 (një); 4- Numri i pjesëmarrjeve në aktivitetet shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit për prezantime të punimeve kërkimore shkencore rezultojnë të jetë 4 (katër); 5- Numri i studentëve të angazhuar në punime shkencore individuale të pedagogëve rezultojnë të jetë 3 (tre). <p><i>(1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, Aneksë RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitetet, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Në vijim të analizës së përbushjes së standarteve të vlerësimit GVJ vlerëson se në fushën e programit të studimit DP/FSHE/UE organizojnë konferenca dhe aktivitetet që ndihmojnë arritjen e objektivave të programit të studimit për studentët dhe personelin akademik. Ndër të tilla aktivitetet mund të përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Konferencat: Konferenca e Parë Ndërkombëtare Studentore "Shkenca e hapur dhe ndërkombëtarizimi"; Forumi "Toleranca Përtej Kulturës"; Konferenca e 2-të Ndërkombëtare "Globalizimi dhe Integrimi në Edukimin Bashkëkohor"; Konferenca Shkencore Kombëtare "Tradita arsimore e Elbasanit nga mesi i shek. XIX deri në vitet '30 të shek XX"; etj. 2- Workshope, tryeza diskutimi: Workshopi "Kërkimi shkencor mes ndërkombëtarizimit dhe sfidave"; "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike"; "Aleanca kundër gjuhës së urrejtjes një diskutim gjithëpërfshirës"; Tryeza e shtatë e rumbullakët e çështjeve të barazisë gjinore "Zëri i grave dhe vajzave"; etj. 3- Leksione, orë të hapura me lektorë të huaj: "Drejtesia riparuese dhe kontribuese: Një qasje metodologjike", etj. <p><i>(1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, Aneksë RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22; 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit MSC PE ofron një kurrikul të plotë dhe të mirëorganizuar për të formuar profesionistë konkurrues për tregun e punës vendas e të huaj, duke ofruar dije të kombinuara teorike dhe praktike në fushën e psikologjisë në përgjithësi dhe në fushë të psikologjisë së edukimit në veçanti.</p> <p>Në vlerësimet e tregut të punës dhe të punësimit të të diplomuarve që ka realizuar DP rezultojnë në marzh të kënaqshëm të punësimit të të diplomuarve në programet e studimit të psikologjisë. Sipas këtij raporti rezultojnë se "Më</p>

	shumë se gjysma e studentëve ë diplomuar në 4 vitet e fundit, që kane marre pjesë në studim raportojne të jenë të punësuar aktualisht dhe mbi 80% e tyre e kane pasur të paktën një punë deri në momentin e anketimit”. (2.19 Studimi i tregut të punës; 2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit; Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2019-2021, 2020-2022 dhe 2022-2024- dokumentacion shitesë në e-ascal)			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i studimit MSc. PE ofruar nga Departamenti i Psikologjisë sipas akteve ligjore Kombëtare është i rregulluar me anë të Ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 40/2016 për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Sikurse është evidentuar edhe me herët në vlerësimin e Standartit II.5, kriteri 3 GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë duhet të rikonsiderojë elementë të punës së tij dhe akteve rregullatore të tij në përputhje dhe zbatim të kërkesave, kriterëve dhe rekomandimeve të akteve të sipërcituara në dokumentat themelore strategjike të Departamentit dhe programeve që DP ofron, në konsiderim të kërkesave të urdhrin të kriteret e pranimit të studentëve.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	GVJ vlerëson se programi i studimit garanton njohuri të thelluara në fushën e studimeve mbi psikologjinë e edukimit, ofron mundësi për t'u integruar në mjedisin kërkimor shkencor ndërkombëtar siguruar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit si dhe veprimtarive me karakter kërkimor shkencor të përbashkëta nga UE, FSHE dhe DP.			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e studimeve të UE, kreu III, plani mësimor i programit të studimit hartohet nga departamenti dhe miratohet nga Senati Akademik, githashtu, programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës dhe paraqiten për miratim në fillim të çdo viti akademik në Departament dhe një kopje e tij depozitohet në formë elektronike dhe shkresore në Drejtorinë e kurrikulave dhe standarteve.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit përmban peshën specifike të orëve të leksioneve, seminarëve, laboratorëve, praktikave institucionale dhe orëve individuale për çdo lëndë të programit të studimit MSc. PE. Nga ana tjetër, programi i lëndës përmban objektivat, konceptet themelore të lëndës, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, detyrimet e studentit për punime individuale si ese ose detyra kursi, detajimin e përmbajtjes së lëndës sipas orëve në dispozicion për cilindo komponent mësimor si leksione, seminarë, praktika e laboratore. Të gjithë komponentët e planit mësimor të programit të studimit MSC. PE dhe të programeve lëndore janë të miratuara nga institucioni në fillim të çdo viti akademik.</p> <p><i>(Anekset e RVB-tabela 10, tabela 9, tabela 13, tabela 15; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve, 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; Plani mesimor_Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-asca)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi programet e lëndëve GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit planifikon dhe përdor një larmi formash mësimdhënieje për të trajtuar materialin mësimor në mënyrë të larmishme, duke e diferencuar edhe sipas nevojave të studentëve. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentë të progamit të studimit, GVJ evidentoi zbatimin praktik të mënyrave të shumta të mësimdhënies si tryeza të rrumbullakëta, punë në grup, debate mbi tema të caktuara, ese, projekte minikërkimore, etj. Teknika mësimdhënieje që favorizojnë të mësuarin efektiv dhe që është një tregues pozitiv për respektimin e larmisë së nevojave të studentëve.</p> <p><i>(informacion nga vizita në institucion, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit MSc. PE ka një karrierë akademike të konsoliduar dhe është i kualifikuar në Institucione brenda dhe jashtë vendit. GVJ konstaton se pavarësisht formimit profesional të personelit akademik të programit të studimit, UE ka praktika të mira në mbështetje të përmirësimit të kompetencave didaktike të personelit akademik në funksion të përmirësimit të cilësisë së të mësuarit. Ndër të tilla praktika mund të përmendim tryezat e rrumbullakëta, workshopet, leksionet e hapura, mbajtjen e konferencave shkencore, trajnimeve nëpërmjet programeve</p>

	<p>të shkëmbimit ERSAMUS+ dhe periudhave të mësimdhënies në kuadër të ERASMUS +, të cilat synojnë shkëmbimin e përvojave mes klegëve vendas e të huaj të fushës së studimit në psikologji dhe disiplina shkencore të përafërta. Përvoja të tilla të mundësuar dhe fasilituar nga UE krijojnë kushtet për përmirësim të kompetencave didaktike dhe përditësim të tyre.</p> <p><i>(2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22; 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Aneks RVB-tabela 19; 4.18 Raport per veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+, 3.2 Të dhëna për mobilitetin FSHE, 2.16. CV e personelit akademik dhe ndihmesakademik per programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit MSC. PE kanë kualifikime dhe kontribute univeristare, artikuj të botuar në revista shkencore vendase e të huaja, pjesëmarrje në konferenca e kongrese shkencore, sipas fushave të ekspertizës së angazhimeve të tyre në procesin mësimor. Nga struktura e programeve lëndore, përmbajtja e tyre dhe nga dëshmitë e studentëve gjatë takimeve në institucion GVJ mund të konkludojë se personeli akademik i programit të studimit është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve psikologjike dhe specifikisht edhe në psikologjinë e edukimit, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Metodatat e mësimdhënies karakterizohen nga ndërveprimi me në qendër studentin nëpërmjet metodave të ndryshme si: case study, role play, debat, brain storming, etj. Gjatë mësimdhënies rezultojnë që edhe teknologjia luan një rol të rëndësishëm, duke mundësuar prezantimin e materialeve mësimore audio-vizive, të cilat sigurojnë një mjedis të qëndrueshëm të nxëni të orientuar me në qendër studentin dhe të udhëhequr e mbështetur nga pedagogu në mënyrë që studentët të krijojnë argumenta dhe analiza të qëndrueshme teorike, duke respektuar mendimin e lirë dhe duke konsoliduar respektin ndaj njëri-tjetrit.</p> <p><i>(1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22; 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Aneks RVB-tabela 19; 4.18 Raport per veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik, 2.16. CV e personelit akademik dhe ndihmesakademik per programin e studimit, informacion nga vizita në institucion, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shitesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, informacion nga vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, Departamenti i psikologjisë dëshmon se në komponentët e vlerësimit të punës së departamentit</p>


<p>metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>mësimdhënia dhe cilësia e saj është një nga shtyllat bazë. Ky komponent është një nga elementët e diskutimit në raportet vjetore të punës së departamentit dhe të programit të studimit. Në praktikën e punës DP dëshmon se si njësi përgjegjëse e programit të studimit ka ndërmarrë iniciativa për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe duke reflektuar sugjerimet e tyre në procesin e punës. Edhe pse nuk ka një politikë të qartë institucionale dhe një praktikë të konsoliduar institucionale për vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, DP dëshmon se në praktikën e saj të punës bën përpjekje nëpërmjet bisedave të drejtpërdrejta me studentë ose edhe pyetësorëve individualë mbi personelin akademik të bëjë vlerësime të tilla.</p> <p><i>(1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22, 3.11 Pyetësor i studentëve dhe analiza e pyetësorit, 3.15 Raport vjetor i vetëvlerësimit të programit të studimit, informacion nga vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Universiteti i Elbasanit është pjesë e një memorandumimi mirëkuptimi me 8 institucione të tjera të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe me Institutin e zhvillimit të Arsimit, të cilët në kuadër të projektit TEAVET (ERASMUS +) ngrejnë rrjetin e qendrave të të nxëniet gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve. Një angazhim i tillë dëshmon se UE në nivel institucional nxit, promovon dhe ngre struktura që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura janë qendra të inovacionit dhe përgjegjëse për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja dhe më pas personelin akademik të UE e shndërrojnë në personel trajnues për palë të tjera.</p> <p><i>(3.3 Marrëveshja për krijimin e qendrës)</i></p> <p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit gjithashtu në strukturën e tij organizative ka qendrën për kërkim dhe zhvillim për edukim, që mundëson trajnime në fushën e didaktikës dhe mësimdhënies, si dhe eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>(e-Ascal-Organigrama e FSHE)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, RVB-së dhe vizitës në institucion, konstaton se Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Psikologjisë garantojnë krijimin e strukturave, politikave dhe mundësive që krijojnë kushte të përshtatshme për mësimdhënie inovative dhe në respekt të diverzitetit të studentëve, si dhe nxisin procesin e të mësuarit efektiv dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Universiteti i Elbasanit ka hartuar dhe zbaton një rregullore të posaçme mbi studimet në UE në kreun V të së cilës trajtohen elementët e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit. Në nenin 40, nenin 41 të saj shprehet se: Neni 40: “Kontrolli i dijeve realizohet nëprmjete testimeve/provimeve me shkrim/ me gojë, projekteve/ prezantimeve/ praktikave/ tezave të diplomave. ...Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/ modulit dhe vlerësimi në provën përfundimtare provim/ testim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/ modulet e cilësuar provim në planin mësimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar...” Neni 41: në format e kontrollit të dijeve: “Provimi është forma kryesore e vlerësimit të nivelit të përvetësimit të njohurive që studenti ka përfituar gjatë zhvillimit teorik dhe praktik të një lënde. ...format e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e lëndës/ modulit dhe në planin mësimor të studimeve.”</p> <p>Elementët e mësipërm, Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen edhe në rregulloren e studimeve në FSHE dhe në rregulloren e programit të studimit MSC në PE dhe janë publike dhe njihen nga studentët.</p> <p><i>(1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; 1.20. Rregullore e programit të studimit; Rregullore e studimeve në FSHE- dokumentacion shtesë në e-ascal)</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i prezantuar me RVB-në, rezulton se në zbatim të akteve të brendshme rregullatore të përmendura në kriterin 1, plani mësimor i programit të studimit MSc. në PE, përmban formën e vlerësimit përfundimtar të njohurive në përfundim të lëndës. Gjithashtu, rezulton se në çdo program lënde të hartuar nga titullarët e lëndëve është parapërcaktuar dhe miartuar metodologjia e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara për lëndën.</p> <p>Nga takimet me studentë rezultoi se në javën e parë të çdo semestri studentëve ju prezantohen nga pedagogët e lëndës syllabuset e lëndëve/</p>




	<p>moduleve duke konsideruar në mënyrë të kujdesshme kompetencat e lëndës, objektivat dhe qëllimet lëndore, rezultatet e të mësuarit, metodat e mësimdhënies, metodologjinë dhe komponentët e vlerësimit të studentit dhe dijeve të tij profesionale në përfundim të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe e rekomanduar për studim.</p> <p><i>(informacion nga vizita në institucion, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve; Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-asca)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në proces nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe komponentëve të tij dhe vlerësimit përfundimtar. Mënyrat e vlerësimit të studentit synojnë t'i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, për këtë arsye përdoren si metoda vlerësimi detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, projektet, analizimi i rasteve, esetë, dorëzim dosje, praktika, etj. Kontrolli i njohurive përcaktohet sipas rregullore së studimeve në FSHE edhe në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave "Psikologji Edukimi". Testimi përfundimtar mund të zhvillohet me shkrim, me gojë, ose në mënyrë të kombinuar, sipas parashikimeve dhe miratimit në programin e lëndës/ modulit.</p> <p><i>(1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 45, 1.20. Rregullore e programit të studimit, neni 4; Rregullore e studimeve ne FSHE-dokumentacion shtesë në e-asca; informacion nga vizita në institucion, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UE, FSHE në rregulloren e studimeve dhe DP në rreguloren e programit të studimit për MSc. në PE kanë hartuar dhe zbatojnë procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Sipas nenit 40 të Rregullore së studimeve të UE, vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/ modulit dhe vlerësimi në provën përfundimtare provim/ testim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuara provim në planin mësimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar.</p>

<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Elementët, pesha specifike në përqindje të notës përfundimtare, dhe format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe testimit përfundimtar shprehen në mënyre eksplicite në programet e lëndëve. Në kreun V të rregullores së programit të studimit MSc. PE shprehet qartë se vlerësimi përfundimtar i shprehur në notë i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë semestrit, bëhet pas përfundimit të procesit të korigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit si pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm.</p> <p><i>(1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 40, 1.20. Rregullore e programit të studimit, Kreu V; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve, anekse rvb- tabela 15)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UE ka bashkëpunim me Albanian-American Development Foundation (AADF) për zbatimin e projektit Clean Score mbi cilësinë e materialeve mësimore dhe vlerësimin e performancës së studentëve. Nga ky bashkëpunim është zhvilluar dhe përdoret platforma elektronike e Clean Score të ngritur nga AADF për testime dhe vlerësim të informatizuara të njohurive, të cilat rrisin transparencën dhe objektivitetin në vlerësim.</p> <p><i>(3.4. Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE)</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas nenit 40 të Rregullores së studimeve në UE dhe nenit 25 të rregullores së programit të studimit, vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj dhe kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet e parashkruara në rregulloren e studimeve dhe në programin e lëndës. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet sipas sitemit të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë).</p> <p><i>(1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 40, 1.20. Rregullore e programit të studimit, Kreu V, neni 25; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se në të gjitha format e vlerësimit të njohurive të fituara, vlerësimi i studentit shoqërohet me komente mbi pikat e forta dhe pikat e dobëta në dijet e mësuara dhe aftësitë e përvetësuara në mënyrë që të ndërtohen strategji të suksesshme për të rirorientuar të mësuarin efektiv për të arritur rezultate më të larta në vijim. Vlerësimi i vazhdueshëm dhe provimet e ndërmjetme u evidentuan nga takimet me student dhe personelin akademik si element të rëndësishëm të procesit të “korigjimit” të mangësive nëpërmjet shkëmbimit të komenteve të vazhdueshme, duke synuar përmirësimin e rezultateve të studentit në provën finale dhe në të ardhmen.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion, 1.20. Rregullore e programit të studimit, Kreu V; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të</i></p>



	<i>studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Senati akademik i UE me vendim nr. 15, datë 5.04.2020 ka miratuar Kodin e etikës të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, i cili sipas nenit 3 të tij, zbatohet gjatë veprimtarisë në UE nga i gjithë personeli akademik, kërkimor shkencor, ndihmës akademik dhe studentët e UE-së. Në nenin 15 të Kodit të Etikës parashikohen parimet e etikës gjatë veprimtarisë studentore ndër të cilat edhe ndalesat ndaj plagjiaturës dhe kopjimit në detyra e provime. Kriteret dhe kërkesat mbi sjelljet etike janë të parashtruara edhe në programet e lëndëve të programit të studimeve sipas VKM 41 të ndryshuar në seksionin “kodi i etikës”.</p> <p><i>(6.5 Kodi i Etikës UNIEL; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-asca mbi programet e lëndëve)</i></p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Transparenca me studentët në lidhje me komponentët e vlerësimit dhe peshën specifike të secilit komponent në vlerësim e bën rezultatin e kontrollit të dijeve dhe të aftësive profesionale të bazuar në meritë dhe në skema racionale që minimizojnë ndikimet subjektive. Korrigjimet e automatizuara të provimeve rritin objektivitetin në vlerësim gjithashtu. Sipas nenit 45 të Rregullores së studimeve të UE-së, vlerësimet e studentëve pasqyrohen brenda 6 ditëve në Sitemin e Menaxhimit të të dhënave të UE-së. Procesverbali, i plotësuar me rezultatin e provimit, i gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të të dhënave, dorëzohet në sekretarinë mësimore i nënshkruar nga komisioni përkatës. Gjatë takimit me student, rezultoi se afatet e informimit të vlerësimit respektohen me korrektësi nga personeli akademik programit të studimit MSC. PE.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion, 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL)</i></p>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Rregullorja e studimeve në UE në nenin 46 të saj parashikon të drejtën për ankimim të rezultatit dhe procedurës së vlerësimit dhe realizimit të provimit nga ana e studentit, duke garantuar të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Procedura e parashkruar në rregullore garanton transparencë për palët e përfshira në proces rivlerësimi dhe dokumentohet e arkivohet sipas parashikimeve në nenin 46.</p>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Nga GVB-ja, personeli akademik i programit të studimit dhe studentët u evidentua se nuk ka patur student, të cilët kanë ndjekur procedurën e ankimimit sipas rregullores së studimeve të UE-së. Në praktikat e komunikimit të vlerësimit në programin e studimit evidentohen ura të mira komunikimi që ju mundësojnë studentëve të jene ballë për ballë me pedagogun e lëndës në momentin e komunikimit të vlerësimit dhe</p>

	të konsultimit të menjëhershëm të çdo pakënaqësie të mundshme mbi vlerësimin. (Informacion nga vizita në institucion, 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL)			
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti i Elbasanit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të rregullores së posaçme të studimeve në UE siguron një mjedis ndërveprimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve që mundëson dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Programi i studimit MSc. PE është një program i ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”. Programi i studimit është hartuar mbi bazën e një kurrikule të pasur si në aspektin teorik edhe në atë praktik. Në analizë të planit mësimor të programit të studimit, programeve të lëndëve/ moduleve rezultojnë se programi garanton thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Programi i studimit ofron një kurrikul, e cila në mënyrë të përshkallëzuar dhe të strukturuar integron dijet e formimit metodologjik shkencor psikologjik nëpërmjet lëndëve si: Kërkimi sasior dhe cilësor në psikologjinë e edukimit dhe Vlerësimi zhvillimor dhe testet e matjes, me lëndë karakterizuese për konsolidimin e dijeve të thelluara në psikologjinë e edukimit si: Autizmi dhe trajtimi psikoedukativ, psikologji sociale dhe e aplikuar në komunitet dhe familje, psikologji edukimi e specializuar, terapi dhe këshillim psiko-edukativ, intervenim i hershëm përmes lojës, vlerësimi dhe ndërhyrja në kriza e trauma. Për thellimin e dijeve në praktikën profesionale, studentëve ju garantohej praktika institucionale ku njihen dhe zhvillojnë praktika pune. Aftësitë shkencore dhe dijet në fushën e kërkimit studentët i testojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të lëndëve nëpërmjet projekteve të kursit dhe detyrave kërkimore për t’u finalizuar me temën e diplomës si një tezë komplekse kërkimore individuale e çdo student që ndjek programin.</p> <p>(2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit, Aneksat e Rvb-tabela 9, tabela 10, Plani mesimor_ Master i shkencave në Psikologji Edukimi 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal)</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i studimit MSc. PE nëpërmjet strukturës së tij formative dhe përmbajtësore përpos synimit për të formuar profesionistë të

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>specializuar në fushën e psikologjisë së edukimit, garanton edhe zhvillimin e dimensioneve të tjera humane, sociale e komunikative të studentëve që ndjekin programin e studimit. Marrëdhënia terapeutike, këshilluese, asistuese në lëndë/ module si vlerësimi zhvillimor dhe testet e matjes, çrregullimet në të folur dhe ndërhyrjet terapeutike, trajtimi psikopedagogjik i nxënësve me ADHD, autizmi dhe trajtimi psikoedukativ, terapi dhe këshillim psiko-edukativ, etj., në themel të tyre kanë aspektet komunikative, humane dhe sociale të cilat sigurojnë sfondin e ndërveprimit profesional. Teknologjia e informacionit rezulton të jetë një aset në ndihmesë të informacioneve ndihmëse në funksion të programit të studimit, por edhe në funksion të zhvillimit të aftësive të komunikimit digjital. Në programet lëndore fondi i literaturës së detyrueshme dhe më shpesh literaturës së rekomanduar është në gjuhë të huaj, kryesisht gjuhën angleze, duke krijuar kështu një mundësi të shtuar për studentët e programit të studimit për të zhvilluar aftësitë e tyre edhe gjuhë të huaj në përputhje me fushën e studimeve.</p> <p><i>(2.15 Korniza konceptuale e programit të studimit, Aneksat e Rvb-tabela 9, tabela 10, Plani mesimor_ Master i shkencave ne Psikologji Edukimi 2022-2024- dokumentacion shtesë në e-ascal; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me RVB-në, GVJ-ja konstaton se në syllabuset e çdo lënde, në javën e fundit të procesit mësimor ka një temë përmyllëse në funksion të evidentimit të koncepteve, kompetencave dhe aftësive kryesore të fituara gjatë kursit lëndor. Në orën e fundit të mësimin personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe jep udhëzimet përkatëse për detyrimet përmbyllëse të lëndës/modulit. Një fakt i tillë u evidentua edhe gjatë bisedave me studentë të programit të studimit.</p> <p><i>(Informacion nga vizita në institucion; 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e</p>	<p>Sikurse u evidentua edhe në analizën e kriterëve të standardit III.1, metodat e mësimdhënies në programin e studimit MSc. PE janë të orientuara me në qëndër studentin dhe synojnë të mësuarin aktiv. Në funksion të këtij qëllimi zhvillimi i mësimdhënies mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të servitura për diskutim nga përvoja të punës duke krijuar klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Gjatë vizitave në institucion rezultoi se studentët kanë qënë të angazhuar në veprimtari të ndryshme të karakterit</p>

<p>mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>kërkimor dhe profesional dhe njohuritë e fituara gjatë programit të studimit kanë qënë një bazë e shëndetshme që ata të kishin kompetenca profesionale për të çuar përpara angazhimet e marra në veprimtari si konferenca, punë në institucionet shkollore gjatë praktikave në institucion, dhe zhvillimin e seancave terapeutike me nxënës me problematika të ndryshme.</p> <p><i>(Aneksat e Rvb-së-tablea 5, 2.17. programet mësimore të lëndëve të programit të studimit/syllabuse dhe dokumentacioni shtesë në e-ascal mbi programet e lëndëve; 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22; 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit MSc. PE është vazhdimisht i interesuar për të qënë pjesë e diskutimeve shkencore mes profesionistëve të fushës duke marrë pjesë në aktivitete shkencore si brenda edhe jashtë vendit, duke u informuar mbi zhvillimet e reja në fushën e tyre të ekspertizës dhe në fushën e studimeve psikologjike.</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit dëshmon të jetë një urë lidhëse ndërmjet informacioneve më të fundit të shkencës dhe teknologjisë dhe studentëve të programit të studimit. Personeli akademik i integron këto dije në strukturën e programeve lëndore dhe temave mësimore ose i shpërndan këto njohuri nëpërmjet orëve të hapura të zhvilluara edhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke qënë të angazhuar vetë si lektorë ose edhe duke ftuar kolegë vendas e të huaj ekspertë në fusha të ndryshme që lidhen me programin e studimit.</p> <p><i>(3.16 Organizimi i leksioneve të hapura Dr. LUCA VILLA; EVIDENCA 4.6 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillor të Biznesit 2021-2022; Aneksat RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22; 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022, 1.21 Analiza vjetore e departamentit 19-22; 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; 2.16. CV e personelit akademik dhe ndihmesakademik per programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit të UE, strategjinë e zhvillimit të DP dhe në strategjinë e zhvillimit të programit të studimit MSC. PE studentët dhe veprimtaritë me në qëndër studentin janë prioritete strategjike, të cilat ndër të tjera synohen të realizohen edhe nëpërmjet mbështetjes së tyre për zhvillimin e ideve dhe projekteve dhe studimeve të përparuara kërkimore nga studentët. UE, FSHE dhe DP dëshmojnë praktika pozitive në këtë drejtim duke i përfshirë studentët në projekte kërkimore të fituara nga personeli akademik i departamentit dhe duke financuar konferenca të dedikuara studentore si forume diskutimi në fushën e tyre të studimeve.</p> <p><i>(1.19 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; 1.16 Strategjia e zhvillimit të Departamentit; 1.3 Strategjia e UNIEL; Aneksat RVB- tabela 19, tabela 20, tabela 22; 3.13 Konferenca studentore UE, 3.14 Konferenca studentore AU UFO)</i></p>


Konkluzione	<i>GVJ bazuar në analizën e kriterëve të standartit III.4 konkludon se programi i studimit MSc. PE garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe duke realizuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5


Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në Rregulloren e studimeve rregullon dhe orienton në Kreun VIII: Diplomimi, procedurat dhe detyrimet përmbyllëse. Fakulteti i Shkencave të Edukimit gjithashtu në Rregulloren e studimeve kë Kreun VIII përcakton procedurat e posaçme dhe detyrimet përmbyllëse. Në këto rregullore përcaktohet qartë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Për të fituar diplomën për programin e studimit të kryer, studentit duhet të ketë grumbulluar numrin e krediteve të përcaktuara në atë program studimi; 2- Në programet e cilit të dytë të studimit “Master i shkencave” studentit diplomohet me punim diplome. <p>Në nenin 62 të Rregullores së studimeve në UE dhe në nenin 60 të Rregullores së studimeve në FSHE, përcaktohen procedurat e përgatitjes së punimit të diplomës që nga zgjedhja e temës, caktimi i udhëheqësit të temës së diplomës, hartimi i kalendarit të punës së studentit për realizimin e temës së diplomës, grafikun e konsultimeve, udhëzimet teknike të punimit të diplomës që përfshihen në Manualin e punimit të diplomës.</p> <p>UE dhe FSHE i bëjnë publike për studentët kriteret dhe kërkesat për detyrimet përmbyllëse që në fillim të çdo viti akademik.</p> <p><i>(1.2. Rregullore e studimeve UNIEL, Rregullore e studimeve ne FSHE-dokumentacion shtesë në e-ascal, 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Departamenti i Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit si struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit siguron që personeli akademik të asistojë në mënyrë të vazhdueshme diplomantët duke ju vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p><i>(1.2. Rregullore e studimeve UNIEL Kreu VIII, neni 62, Rregullore e studimeve ne FSHE, Kreu VIII, neni 60 - dokumentacion shtesë në e-ascal, 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final	Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit MSc. PE.

<p>bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në manualin e punimit të diplomës për programet e studimit “Master” përcaktohen qartë përgjegjësitë e udhëheqësit të diplomës ndër të cilat po përmendim disa si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundesojë kandidatit të arrije standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi e ndihmon studentin të përmirësojë stilin e të shkruarit dhe të vetëdijësohet për rrezikun e plagjiaturës. 2- Të mbajë takime të rregullta me studentin (të pakten 2-3 orë në javë). 3- Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht. 4- Të sugjeroje dhe vlerësimin kritik për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës, etj. <p><i>(3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së Studimeve të UE dhe FSHE si dhe Manualit të punimit të diplomës rezulton se Departamenti i Psikologjisë ka gjithë suportin e FSHE dhe UE për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p><i>(1.2. Rregullore e studimeve UNIEL Kreu VIII, Rregullore e studimeve në FSHE, Kreu VIII, - dokumentacion shtesë në e-asca, 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në nenin 65 të Rregullores së studimeve në UE dhe në nenin 63 të Rregullores së studimeve në FSHE përcaktohen procedurat e mbrojtjes së diplomës që nga ngritja e komisionit të vlerësimit, miratimi i komisionit të vlerësimit, caktimi i oponentit të temës së diplomës, dokumentacioni final i dorëzuar për mbrojtjen e temës së diplomës dhe vlerësim para një komisionit të përbërë nga jo më pak se 5 veta.</p> <p>Kriteret specifike të vlerësimit të punimit të diplomës përcaktohen në Manualin e punimit të diplomës pika 2.4. Kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës master në të cilën përfshihen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Cilësia e shkrimit, organizimi, stili, parashtrimi dhe zhvillimi i ideve;



	<p>2- Rëndësia e problemeve, çështjeve apo pyetjeve të ngritura në punim;</p> <p>3- Cilësia e analizës;</p> <p>4- Cilësia e përfundimeve dhe/ose rezultateve;</p> <p>5- Koherenca, karakteri krijues dhe originaliteti;</p> <p>6- Paraqitja gjithëpërfshirëse e literaturës ekzistuese;</p> <p>7- Parashtrimi logjik në paraqitje dhe metodologji;</p> <p>8- Përfundimet.</p> <p>Pesha specifike në notë dhe pikë e elementëve të vlerësimit prezantohet në shtojcën 5: Fletë vlerësimi për punimin e diplomës Master, të Manualit të punimit të diplomës.</p> <p><i>(1.2. Rregullore e studimeve UNIEL Kreu VIII, Rregullore e studimeve ne FSHE, Kreu VIII, - dokumentacion shtesë në e-ascal, 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në Rregulloren e studimeve në UE, neni 66 dhe në Rregulloren e studimeve në FSHE, neni 64 me objekt lëshimin e diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës përcaktohen procedurat dhe kriteret për pajisjen e studentit në përfundim të studimeve të cilit të dytë me diplomën dhe suplementin e diplomës, të cilat janë të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, të cilat janë dokumente me të cilat studentit në mënyrë zyrtare pajiset në përfundim të studimeve.</p> <p><i>(1.2. Rregullore e studimeve UNIEL Kreu VIII, Rregullore e studimeve ne FSHE, Kreu VIII, - dokumentacion shtesë në e-ascal; 3.7 Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit, modeli i diplomës, 3.9 Modeli i suplementit të diplomës të programit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Universiteti i Elbasanit ka një rregullore të posaçme për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumenteve në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të miratuar me vendim Senati Nr. 20, datë 12.04.2020. Kjo rregullore garanton që gjithë aktorët e përfshirë në jetën universitare të UE të trajtojnë sipas legjislacionit në fuqi dokumentacionin e studentit dhe të konsiderojë politikat e mbrojtjes së të dhënave në administrimin e informacionit.</p> <p>Politika e trajtimit të informacionit të studentit përcaktohen edhe në rregulloren e studimeve të UE (kreu VII, Kreu VIII, neni 67,68) dhe në rregulloren e studimeve në FSHE (Kreu VII, Kreu VIII, neni 65,66).</p> <p><i>(1.2. Rregullore e studimeve UNIEL Kreu VIII, Rregullore e studimeve ne FSHE, Kreu VIII, - dokumentacion shtesë në e-ascal; 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në UNIEL)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave të Edukimi, Departamenti i Psikologjisë, kanë hartuar rregullore të të cilat përcaktojnë qartë procedurën e detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit MSC. PE dhe në përmbyllje të</i></p>



	<i>studimeve e pajisin studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përbushur plotësisht standartin III.5.</i>			
Shkalla e përbushjes sëstandardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.6				
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit MSc. PE.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfundimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit MSc. PE.			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit MSc. PE.			
Konkluzione	<i>Programi nuk është Master Profesional, për këtë arsye Standardi quhet i përbushur plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi korrekte të shpalljeve publike, si dhe përmes mjeteve të komunikimit që insitucioni ka në dispozicion si faqja e universitetit dhe rrjetet sociale, sipas të gjitha kriterëve. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit, gjë që shihet në dokumentacionin e dorëzuar, por u konstatua edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Nga sa më sipër GVJ konstaton se, numri i personelit akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në këtë program studimi është i njëjtë dhe në përputhje me profilin e programit të studimit në të cilin kontribuojnë.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv i përfshirë në këtë program studimi mbulon ngarkesën mësimore sipas kornizës ligjore në fuqi.</p> <p>Stafi me kohë të plotë i angazhuar ka tituj dhe grada shkencore në përputhje me fushën e studimit.</p> <p><i>Aneks 4.5 Ngarkesa mësimore e personelit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UNIEL garanton një qëndrueshmëri afatgjatë të stafit të brendshëm të përfshirë në këtë program studimi. Të gjitha kontratat e personelit efektiv dhe atij me kohë të pjesshme gjenden të depozituara pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektorat. Në secilën dosje të personelit gjendej dokumentacioni nevojshëm duke nisur nga CV, dokumenti identifikimit, diploma e tituj të fituar, artikuj shkencor etj. Gjithashtu, institucion ka dorëzuar edhe listën e pagesave për një periudhë 6 – mujore.</p> <p><i>Evidencë 4.1. Listpagesa e personelit janar – qershor 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në fillim të vitit akademik nëse ka nevoja për pedagogë efektivë ose me kohë të pjesshme publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti. Kandidati konkuron pas identifikimit të nevojave për të mbuluar ngarkesën mësimore. Të interesuarit pas marrjes së njoftimit në faqen zyrtare të universitetit, depozitojnë në zyrën e BNj pranë Rektoratit dosjen me të gjitha dokumentet e kërkuara. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare ëeb të UE dhe Buletin e Njoftimeve Publike. E gjitha procedura zhvillohet e kontrolluar nga</p>

	<p>rektorati pasi zyra e burimeve njerëzore është vetëm një. Të gjitha procedurat ndiqen sipas rregullave në fuqi. Grupi i ekspertëve verifikoi në terren dosjet e personelit akademik pranë kësaj zyre. Dokumentacioni rezultoi i rregullt dhe i organizuar sipas departamenteve përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 4.2. Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, edhe gjatë vizitës në institucion u evidentuan laboratorë brenda institucionit, por që nuk lidheshin drejtpërdrejtë me programin e studimit. Këto laboratorë i shërbejnë programeve të edukimit, që janë pjesë e institucionit në tërësi. Ndërkohë mjediset e tjera mësimore janë të përshtatshme për natyrën dhe organizimin e programit të studimit.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron që është e domosdoshme krijimi një laboratorit me të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme që do i shërbejë këtij programi studimi. Departamenti ka hartuar një projekt propozim për hapjen e laboratorit të parë psikologjik, në shërbim të të gjitha programeve të studimit. Kjo është e rëndësishme, edhe pse procesi sapo ka nisur.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, evidentoi që UNIEL ruan dhe përditëson pranë zyrës së burimeve njerëzore të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të personelit akademik. GVJ zgjodhi disa dosje dhe shqyrtoi të gjitha të dhënat e përfshira në të, të cilat janë konform rregullave dhe kodit të punës. U konstatua gjithashtu që për të gjithë universitetin ka vetëm një zyrë burimesh njerëzore që përgjigjet për dokumentacionin e të gjitha departamenteve.</p> <p><i>Evidencë 4.5. Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin 2021 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në këtë program studimi por jo vetëm, praktikat profesionale ndiqeshin gjithmonë nga një ose dy pedagogë. Kjo gjë kishte krijuar pakënaqësi në radhët e pedagogëve efektiv, të cilët kërkuan një shpërndarje më gjithëpërfshirëse për orët e praktikës. Ky fakt u vërtetua edhe gjatë intervistës së zhvilluar me studentët, të cilët përmendën të njëjtët persona.</p> <p>Departamenti informon studentët lidhur me kriteret e procedurat e punimit të diplomës për diplomimin në programin e studimit nëpërmjet takimeve peridoike që zhvillon. Departamenti vendos në dispozicion të studentëve rregulloren e diplomimit si dhe udhëzuesin e diplomës. Ai bën një shpërndarje të personelit akademik që do përfshihet në udhëheqje. Nga intervista me studentët u evidentua që ata bëjnë një kërkesë ku shprehin preferencat e tyre dhe më pas është departamenti që i orienton.</p>


	<i>GVJ sugjeron që në vitet e ardhshme të ketë një shpërndarje të barabartë të orëve të praktikës dhe udheheqjeve të diplomave për të gjithë personelin akademik efektiv.</i>		
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni zotëron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për ndjekjen e praktikave profesionale për studentët. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi dokumentacionin e dorëzuar lidhur me praktikat si dhe procedurat e zhvillimit të tyre. Në intervistën e zhvilluar me studentët u qartësuan qëndrat dhe institucionet pritëse, kohëzgjatja e praktikës për to, e cila është në përputhje me marrëveshjet e dorëzuara. Personeli pritës në institucion angazhohej për realizimin e praktikave profesionale në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Sërisht, GVJ sygjeron një shpërndarje më të barabartë të orëve për praktikat mësimore në radhët e pedagogëve efektiv. <i>Evidencë 1.14. Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ nga analiza e dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion e klasifikon këtë standard të përmbushur kryesisht pasi duhet të mbahet në konsideratë një shpërndarje më efektive e orëve të praktikës, gjë që kishte krijuar pakënaqësi në radhët e personelit me kohë të plotë. Gjithashtu, mungojnë laboratorët që i vijnë në ndihmë këtij programi studimi. Pjesa e rekrutimit dhe ruajtjes së dokumentacionin është në nivele të duhura në zyrën e burimeve njerëzore në rektorat.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Fakulteti ka në dispozicion të procesit mësimor: auditore për leksione, auditore për seminare, zyra për personelin akademik dhe atë administrativ, sekretarinë mësimore, zyra për përgjegjësit e departamenteve, zyra e dekanit etj. Mjediset dhe ambientet ishin të mjaftueshme dhe në përputhje me të gjitha kërkesat për një mësimdhënie optimale, duke respektuar kështu edhe hapësirat për cdo student. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të mjaftueshme për numrin e studentëve për këtë program studimi. Kushtet janë optimale dhe në përputhje me kërkesat që ka vetë institucioni. Ambientet janë në përputhje me kërkesat e programit duke krijuar mundësinë e krijimit të tryezave të rumbullakëta, fokus – grupeve etj. <i>Evidencë 4.7. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit.</i>

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësinë të shihte ambjentet ku zhvillohej mësimi, zyrat e personelit e më gjerë. Në tërësi universiteti zotëron ambjente komode, sallë konferencash etj. Studentët zhvillojnë orët e leksionit në salla të përshtatshme për një numër të lartë studentësh dhe orët e seminarit në salla më të vogla. Pavarësisht kushteve optimale, gjatë vizitës në salla leksionesh dhe seminaresh u evidentua mungesa e mjeteve elektronike dhe të teknologjisë së informacionit tek një pjesë e tyre. Kjo gjë çënon mbarëvajtjen optimale të procesit mësimor teorik dhe praktik.</p> <p><i>GVJ sygjeron pajisjen me mjete elektronike dhe teknologjike për të gjitha sallat e leksioneve dhe seminare që janë në funksion të këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mjediset mësimore në fakultet përmbajnë laboratorë të ndryshëm, por nuk janë në funksion të këtij programi studimi. Ato i shërbejnë më së shumti fushës së edukimit. Ndërkohë laboratorit informatikës është i vetmi që është në dispozicion për studentët e këtij programi studimi. Do ishte në interes të studentëve për këtë program krijimi laboratorëve të dedikuar për to. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të mjaftueshme, por mungojë laboratorët.</p> <p><i>Aneks tabela 16. Mjediset e fakultetit njësisia bazë.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UNIEL ka siguruar të paktën një laborator të teknologjisë së informacionit, i cili është edhe në funksion të këtij programi studimi. Ky laborator ka të instaluar programet që u vijnë në ndihmë studentëve për të zhvilluar punë të ndryshme kërkimore, detyra kursi apo dhe punime diplome.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Praktika mësimore zhvillohet pranë institucioneve dhe shoqërive shtetërore ose/dhe private, me të cilat Fakulteti dhe Departamenti ka marrëveshje në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave në Psikologji Edukimi. Të gjitha marrëveshjet janë në përputhje me programin e studimit. Studentët supervizohen dhe orientohen nga drejtuesit e praktikës. Kjo gjë u dëshmuar edhe gjatë intervistës me ta, ku secili tregoi rrugëtimin e tij në ndjekjen e praktikës profesionale. Pjesa mbizotëruese e studentëve ishin të shpërndarë në shkolla pranë zonës së tyre të banimit.</p> <p><i>Evidencë 1.14. Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ e klasifikon të përmbushur plotësisht këtë standard, me përjashtim të pasurimit të sallave me mjete dixhitale për realizimin e orëve mësimore në këtë program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti Shkencave të Edukimit ka në mjediset e tij bibliotekën mësimore, e cila është në funksion të studentëve dhe personelit akademik. Çdo student/pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të përdorimit të katalogut elektronik online. E gjithë literatura e përdorshme në fushën e psikologjisë gjendet në mjedisin e bibliotekës dhe jepet e dokumentuar. Ajo që u vu re gjatë vizitës në institucion lidhet me faktin që në fakultet biblioteka është e vogël, ndërkohë të gjithë mund të aksesonin më shumë libra fizikisht ë bibliotekën në Rektorat. Aty gjenden libra të fushës së psikologjisë, por janë pak të vjetër dhe jo të gjithë të lidhur specifikisht me këtë program studimi. Studentët kanë mundësi të marrin libra dhe material të ndryshme burimore edhe në bibliotekën online JSTROE dhe U-Library.</p> <p><i>Evidencë 2.7 – Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.</i> <i>Evidencë 2.8. – Fondi librit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, por edhe gjatë intervistës me grupet e punës, nuk u evidentua një përpjekje konkrete lidhur me përditësimin e literaturës për këtë program studimi. Një pjesë e lëndëve mbulohen me leksione të përgatitura nga pedagogu ose libra të cilat kanë kohë që janë botuar.</p> <p><i>GVJ sugjeron që kjo të mbahet në konsideratë për vazhdimësinë e këtij programi. Të përditësohet literatura me zhvillimet e fundit në fushë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kapaciteti që ka biblioteka nuk garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Për fushën e psikologjisë janë më shumë libra në versionin online sesa në atë të printuar dhe në gjuhën shqipe.</p> <p><i>GVJ sugjeron që është e nevojshme që Fakulteti të bëjë përpjekje të mëtejshme për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit pasi është i varfër dhe jo i pajisur me literaturë bashkëkohore.</i></p> <p><i>Evidencë 2.7 – Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.</i> <i>Evidencë 2.8. – Fondi librit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj. Në fondin e bibliotekës gjenden libra në fushën e psikologjisë në vecanti dhe shkencave sociale në tërësi. Literatura është fizikisht dhe online në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja. Në bibliotekë ka gjithashtu revista, buletine shkencore në format hardcopy dhe elektronik, fond ky që plotëson nevojat e të gjithë përdoruesve. Vihet re nevoja e pajisjes me libra në fushën e psikologjisë së edukimit, të përditësuar të viteve të fundit.</p>

mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ sugjeron pajisjen me libra që lidhen me programin e studimit ku studentët të kenë mundësi t'i aksesojnë fizikisht në gjuhën shqipe.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Fakulteti Shkencave të Edukimit, si pjesë e Universitetit të Elbasanit, ka krijuar mundësi për të aksesuar në biblioteka të ndyrshme online, në të cilat mund të gjejsh libra dhe artikuj shkencor bashkëkohorë. Studentët dhe personeli akademik mund të bëhen pjesë shumë lehtë e abonimit vjetor në bibliotekën online dhe të marrin informacione të ndyrshme në disiplinën që ata studiojnë. Biblioteka online është pa pagesë dhe lehtësisht e aksesueshme. Studentët dhe pedagogët janë njohur gjithashtu edhe me një manual përdorimi. Në të njëjtën kohë ata mund të aksesojnë revistën e universitetit e cila është periodike dhe përmbledh të gjitha fushat. <i>Evidencë 2.7 – Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.</i> <i>Evidencë 2.6 – Të dhëna mbi revistën periodike UNIEL</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e Fakultetit, por edhe ajo e Universitetit ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolina studimi, kompjutera dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesojë bibliotekën online.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që orari përdorimit të bibliotekës është në përshtatje me zhvillimin e procesit mësimor. Studentët mund të aksesojnë libra edhe pranë fakultetit por edhe në rektorat. Gjithashtu ata kanë mundësi të lexojnë literature online. <i>Evidencë 4.11. – Të dhëna mbi orarin e shërbimit të bibliotekës UNIEL.</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se pranë bibliotekës kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online dhe fizik në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët. Fakulteti bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfutur edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre. GVJ gjatë vizitës dhe intervistave të zhvilluara evidentoi një kërkesë në rritje për pasurimin e fondit ekzistues në këtë drejtim. Prania e një reviste periodike krijon mundësi për stafin akademik të botojë gjetjet e tyre, por jo vetëm. Universiteti ka zhvilluar edhe konferenca studentore duke krijuar një hapësirë të vogël studimi edhe për punimet e studentëve.
Konkluzione	<i>GVJ nga analiza e dokumentacionit ekzistues, vizitës në institucion dhe intervistave të zhvilluara sugjeron që të pasurohet edhe më shumë me</i>

	<p>libra në fushën e psikologjisë biblioteka në nivel fakulteti por jo vetëm, duke i ardhur kështu në ndihmë këtij programi studimi. Gjithashtu do ishte në interes të studentëve shtimi posteve të punës me kompjutera dhe programe kompjuterike që mund të përdoren për analizat sasiore dhe cilësore në fushën e psikologjisë. Këto rekomandime i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së shërbimit për këtë program studimi, edhe pse aktualisht nga vizita në institucion kushtet janë në tërësi të përshtatshme dhe ky kriter përmbushet plotësisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe vizitave në Institucion i gjithë informacioni në lidhje me studentët menaxhohet nëpërmjet sistemit nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore regjistron elektronikisht të dhënat e studentëve duke ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave në fuqi. Ajo mban në dosje dhe arkivon dokumentet e cdo studenti të regjistruar, të c' regjistruar apo që kanë përfunduar studimet, sipas nenit 70 të rregullores së FSHE. Gjithashtu, sekretaria bën kalimin e studentëve në vite pasardhëse sipas numrit të parashikuar, ruan në formë elektronike procesverbalet e vlerësimit. Gjithashtu, falë këtij sistemi informatik sekretaria nxjerr dokumente elektronike mbi bazën e të dhënave, sic janë vërtetime në lidhje me statusin e studentit; lista notash të studentit, raporte statistikore në lidhje me ecurinë e studentëve si dhe në lidhje me numrin e studentëve sipas programeve mësimore.</p> <p><i>Evidencë 1.7 – Rregullore FSHE</i> <i>Evidencë 4.12 – Rregullorja EMS</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>FSHE nuk ka një platformë e cila ti shërbejë drejtpërsëdrejti sistemit të brendshëm të menaxhimit që administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. I gjithë dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrative menaxhohet dhe ruhet në zyrën e Burimeve Njerëzore e cila është vetëm në Rektorat. Në këtë zyrë secili pedagog ka dosjen e tij personale të përditësuar me zhvillimet që stafi ka bërë gjatë punës së tij kërkimore-shkencore, në drejtim të fitimit të gradës apo titujve akademik. GVJ gjatë vizitës në këtë zyrë dhe intervistës me personelin, konstatoi që i gjithë universiteti ishte i përmbledhur vetëm në një zyrë. Për këtë arsye, nisur nga numri i madh i stafit që punon në UNIEL, GVJ sugjeron krijimin e</p>

	<i>strukturave të vogla pranë secilit fakultetit, për të lehtësuar dhe kontrolluar më mirë punën në këtë sektor.</i> <i>Evidencë 1.4 – Rregullore e organizimit të UNIEL, neni 14, neni 16</i>		
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar evidentohet që sistemi menaxhimit siguron akses për informacione dhe dokumente për studentët dhe pedagogët. <i>Evidencë 4.12. – Rregullorja EMS.</i>		
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Personeli akademik shkëmben informacion me studentët me anë të emaileve zyrtare dhe sistemit teams ku cdo student është i pajisur me një username dhe password nga IT e institucionit. Platforma Teams, e cila u përdor gjerësisht gjatë mësimin online, i ofron mundësi stafit akademik të ngarkojë leksionet dhe materialet ndihmëse në funksion të lëndës. Gjatë periudhës së pandemisë kjo platformë ka rezultuar shumë e suksesshme për mësimdhënie, provime, punë në grupe etj. Ajo përdoret ende për të shkëmbyer material së bashku. <i>Evidencë 6.1 – Guida e pedagogut sistemi Microsoft Teams</i>		
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit, GVJ konstatoi se aktualisht nuk ka një sistem institucional funksional që të mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Raportimi i aktivitetëve të ndryshme realizohet vetëm në faqen zyrtare të UNIEL. <i>GVJ sugjeron krijimin e një portali të dedikuar për studentët të cilët do të kenë mundësi të informoheshin në kohë reale për procesin e mësimin, programet, materialet lëndore, literaturën e rekomanduar etj.</i> <i>Evidencë 4.13 – Të dhëna mbi publikimin në faqen zyrtare.</i>		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UNIEL publikon vazhdimisht informacion që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet, konferenca, publikime etj. Ajo që vihet re është mungesa e një sistemi të tillë në nivel fakulteti, ku mund të publikohen më ngushtësisht të gjitha aktivitetet që zhvillohen. <i>Për këtë arsye, GVJ sugjeron krijimin e një mundësie raportimi apo publikimi edhe për Fakultetin e Shkencave të Edukimit në vecanti.</i> Nuk identifikohen të dhëna që lidhen drejtpërdrejtë me programin e studimit. <i>Evidencë 4.13 – Të dhëna mbi publikimin në faqen zyrtare.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ e klasifikon të përmbushur plotësisht këtë standard. Të gjitha të dhënat që publikohen janë në nivel universiteti, por do ishte në interes të fakultetit të ketë një faqe të dedikuar për secilin program studimi ku të gjithë të kenë mundësi të informohen.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Fakulteti Shkencave Edukimit, në varësi të departamenteve dhe secilit program studimi, harton pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit. Raportet financiare dorëzohen në Degën rajonale të Tatim Taksave çdo fund muaji Mars.</p> <p><i>Evidencë 2.3 – Miratim buxheti 2021 – 2022</i> <i>Aneks Tabelë 18 – Të ardhurat dhe financimet e ndryshme tre vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në raportin financiar paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. Ky plan financiar buxhetohet më pas sipas nevojave dhe kërkesave që ka vetë departamenti, në funksion të programit të Psikologjisë së Edukimit. Asnjë program studimi nuk ka buxhet të individualizuar.</p> <p><i>Evidencë 2.3 – Miratim buxheti 2021 – 2022</i> <i>Aneks Tabelë 18 – Të ardhurat dhe financimet e ndryshme tre vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Njesia e Auditimit të Brendshëm, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr 100 date 25.10.2016 “Per miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Institucioni kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Fakulteti Shkencave Edukimit harton raportet dhe pasqyrat financiare, të kërkuara nga ligji. Këto raporte financiare dokumentojnë gjendjen financiare dhe shpërndarjen e burimeve financiare.</p> <p><i>Evidencë 4.14 – Raporti Auditit KLSH 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Duke iu referuar RVB së, konstatojmë se në mbylljen e ciklit të plotë të studimeve, institucioni dokumenton raporte financiare për tri vitet e kaluara akdemike. Më pas në bazë të nevojave dhe kërkesave planifikon ndërhyrjet e nevojshme për ecurinë e mëtejshme të programit.</p> <p><i>Evidencë 2.3 – Miratim buxheti 2021 – 2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për</p>	<p>Informacioni i vënë në dispozicion mbi qëndrueshmërinë financiare të institucionit dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë</p>





zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	kohës së zhvillimit të programit të studimit. Referuar të dhënave institucioni ka asete që justifikojnë mbulimin e shpenzimeve në drejtim të zhvillimit e vazhdimësisë institucionale.			
Konkluzione	<i>GVJ e klasafikon të përmbushur plotësisht këtë kriter, pasi zbatohen procedurat ligjore dhe rregullat në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencial, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit dhe strukturën e programit të studimit paraqiten në faqen e internetit të UNIEL. Programi i studimit është ndërtuar dhe bazuar në rregulloren e vet përkatëse të programit të studimit, në rregulloren e universitetit, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Evidencë 1.1 – Statuti Universitetit të Elbasanit.</i> <i>Evidencë 1.7 – Rregullore Fakultetit të Shkencave të Edukimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Institucioni mbështetet në rregulloren e tij, procedurën e transferimit, për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendëshme e këtij fakulteti. Gjithashtu fakulteti në fillimin e çdo viti akademik ngrë komisionin ad-hoc për procesin e pranimit të studentëve.</p> <p>Këtu duhet evidentuar mungesa e Zyrës së Karrierës për fakultetin, e cila do të shërbente si një urë shumë e mirë informimi dhe komunikimi për studentët. <i>Për këtë arsye, GVJ sugjeron hapjen e një zyre karriere në nivel fakulteti për të ndihmuar të gjithë studentët në orientimin e tyre gjatë studimeve por edhe në tregun e punës.</i> Kjo zyrë sipas evidencave ekziston vetëm në nivel universiteti, gjë që tregon se nuk është pranë secilës njësi bazë.</p> <p><i>EVIDENCE 1.2. Rregullore e UNIEL, neni 52, 53</i> <i>EVIDENCE 2.18 Propozim departamenti për ngritje komisioni ad hoc pranimit në programin e ciklit të dytë të studimeve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës</p>	<p>Në faqen zyrtare të UNIEL janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studentit. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në sekretari dhe faqen zyrtare të universitetit mbi këtë</p>

shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.		
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të fakultetit dhe sipas kriterëve specifikë që mund të propozohen nga Departamenti dhe miratohen në Senatin Akademik.</p> <p>E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në sekretari dhe faqen zyrtare të universitetit mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.</p> <p><i>EVIDENCE V. Manuali Studentit</i> <i>EVIDENCE 1.1 : Statuti I UNIEL, neni 46, 47, 51</i> <i>EVIDENCE 1.4. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit, neni 15</i> <i>EVIDENCE 5.5. Fletëpalosje promovuese institucionale</i></p>		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Përpara fillimit të cdo viti akademik, UNIEL informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programin e studimit. Vendimet për kriteret specifikë dhe të përgjithshme, për pranimin në programin e studimit, janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, aktet nënligjore dhe procedurat që ndiqen në maturën shtetërore e më gjerë.</p> <p><i>EVIDENCE 5. I Vendimi i Senatit Akademik per kapacitetet 2022-2023</i></p>		
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Përpara fillimit të cdo viti akademik, UNIEL harton kriteret e përgjithshme dhe të veçanta duke patur në fokus kandidatët me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara. UNIEL zbaton të gjitha rregullat dhe ligjet në fuqi referuar këtij procesi.</p> <p><i>EVIDENCE 5. I Vendimi i Senatit Akademik per kapacitetet 2022-2023</i></p>		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Një element tjetër i rëndësishëm lidhet edhe me kandidatët nga shtetet e tjera, të cilët mund të jenë pjesë e UNIEL sipas kriterëve që ai vetë publikon në fillim të cdo viti akademik. UNIEL zbaton të gjitha rregullat dhe ligjet në fuqi referuar këtij procesi.</p> <p><i>EVIDENCE 5. I Vendimi i Senatit Akademik per kapacitetet 2022-2023</i></p>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Institucioni harton politika të ndihmës apo bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit, sipas vendimit të Bordit të Administrimit të UNIEL.</p> <p><i>EVIDENCE 5 .2. Vendimi i Bordit te Administrimit per bursat dhe perjashtimet.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se IAL përmbush të gjitha kriteret dhe rregullat në fuqi lidhur me pranimin, transferimin, regjistrimin, orientimin e studentëve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, kriteret e përparimit dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet këshillimit me stafin akademik gjatë fazës së interesimit për programin e studimit; informacionit që merret në Sekretarinë mësimore, në rregulloren e programit të studimit, në website të UNIEL etj. <i>EVIDENCE 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i> <i>EVIDENCE 1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave Psikologj i Edukimi"</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Duke iu referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion konstatuam se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi njohjen e studimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme sipas kërkesave dhe nevojave të tyre kurikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimet e realizuara me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët specifike, bëhet nga pedagogu i lëndës si dhe pasqyrohet në programin e lëndës, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të syllabusit të lëndës dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Silabuset janë në dispozicion të studentëve nga pedagogu. Studentët pohuan se njihen me format e vlerësimit të njohurive, nga komunikimi i drejtpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillim të procesit mësimor kur bëhet dhe prezantimi i përgjithshëm i lëndës.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Sipas rregullores së programit të studimit UNIEL ka miratuar kriteret që duhen plotësuar për të shkuar drejt mbrojtjes së punimit të diplomës për këtë program studimi. Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, dhe të gjitha fazat që të shpjen në mbrojtjen e diplomës. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura që në fillim të cdo viti akademik. <i>EVIDENCE 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i> <i>EVIDENCE 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konkludon se, UNIEL ofron informacione të organizuara në website si dhe në ditët e informimit të studentëve. Veprimtari të tilla, kanë për qëllim të njohin maturantët me programet e studimit që ofrohen nga UNIEL si dhe i ftojnë në "Javën e orientimit". Përmes grupeve të punës të përbërë nga staf akademik informohen maturantët që janë të interesuar të studiojnë në UNIEL. Institucioni ka bërë video promovuese si dhe fletëpalosje, ku cdo student mund të informohet paraprakisht. <i>EVIDENCE 5.3 Kalendar i diteve të hapura 2022</i> <i>EVIDENCE 5.4 Publikimi i spotit promovues</i> <i>EVIDENCE 5.5 Fletëpalosjet promovuese institucionale</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni përmbush të gjitha kriteret dhe rregullat në fuqi lidhur me vënien në dispozicion të studentëve të programit të</i>

	<i>studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një morie formash si rregullores së këtij program studimi, faqes zyrtare të institucionit, fushatave informuese, fletëpalosjeve, etj. Gjithashtu, studentët informohen nga zyra e pranimit dhe rregjistrimit në sekretarinë mësimore, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Duke iu referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion konstatuam se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së rregjistrimit, gjatë ditëve të orientimit. Syllabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimin, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. <i>EVIDENCE 4.12 Rregullorja EMS</i> <i>EVIDENCE 4.13 It dhena mbi publikimin ne faqen WEB</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në shqyrtimin e dokumentacionit, si dhe nga intervistat me stafin akademik, GVJ konstatoi se ka një përpjekje për të studiuar tregun e punës dhe orientuar më tej studentët. UNIEL organizon në mënyrë të vazhdueshme takime, sesione informuese, orë të hapura me përfaqësues të institucioneve dhe bizneseve të cilat ofrojnë mundësi punësimi. Studentët janë pjesë e vazhdueshme e këtyre takimeve. <i>Për këtë arsye, GVJ sugjeron krijimin e zyrës së karrierës edhe pranë fakultetit për të qenë më pranë studentëve dhe nevojave që ata kanë.</i> <i>EVIDENCE 4.6 Lista e aktiviteteve te Bordit Keshillimor te Biznesit 2021 -2022</i> <i>EVIDENCE 5.6 Te dhëna mbi studentët perfitues te programit te nxitjes se punesimit</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të gjerë dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimeve të ndryshme që ofron në faqen zyrtare të UNIEL. Por edhe përdorimi i platformave elektronike në procesin e mësidhënies nga stafit si “Microsoft Teams” sigurojnë akses

shërbimet në funksion të realizimit të tij.	në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, aksesit i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin, detyrat e kursit etj. <i>EVIDENCE 4.13 Te dhena mbi publikimin ne faqen zyrtare</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm në llogarinë e dedikuar të EMS që përdoret për çështjet akademike të studentëve, si regjistrimi, menaxhimi i studentëve, stafi akademik, degët e studimit, lëndët, provimet etj. Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga sekretaria mësimore. <i>EVIDENCE 4.13 Te dhena mbi publikimin ne faqen e WEB</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni përmbush të gjitha kriteret dhe rregullat në fuqi lidhur me vënien në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. Këtu duhet të mbahet në konsideratë krjimi një zyre karriere në nivel fakulteti për të qenë më pranë studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike. Numri i studentëve regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike është: Për vitin akademik 2021-2022 11 studentë Për vitin akademik 2020-2021 13 studentë; Për vitin akademik 2019-2020 13 studentë; Viti akademik 2022 – 2023 nuk pati studentë të regjistruar, ndaj nuk u hap viti i parë. Kjo gjë çënon ecurinë e programin dhe rrezikon më tej vazhdimësinë e tij.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Çdo student është i pajisur me dosjen personale, pavarësisht statusit që ka si student efektiv, i çrregjistruar nga programi i studimit, apo si ish student. I gjithë ky dokumentacion gjendet i arkivuar pranë sekretarisë mësimore. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Të gjitha këto të dhëna gjenden pranë sekretarisë mësimore dhe janë të hedhura sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi. Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike, konstatojmë se numri i studentëve të regjistruar është në rënie dhe në vitin aktual nuk është



	regjistruar asnjë student. Ky është një element shumë problematik për këtë program studimi pasi nëse nuk ka sërish prurje, mund të rrezikojë mbylljen e tij.								
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se të dhënat statistikore burojnë nga Rregjistri themeltar, Rregjistri i rezultateve akademike si dhe Rregjistri i diplomave. Të dhënat statistikore gjenden në version elektronik dhe letër. Këto të dhëna raportohen rregullisht pranë MASR dhe rektoratit të UNIEL.								
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Edukimit përpilon, administron dhe mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e regjistrat themeltar, të hartuar në mënyrë manuale dhe elektronike. Sekretaria mësimore administron regjistrat për çdo program studimi, regjistrin e diplomave, dosjet personale të studentëve, dokumentacionin e procedurave të transferimit apo çregjistrimit, regjistrin bazë të notave, procesverbalet e provimeve etj. Marrja e informacionit dhe njohja me dokumentacionin për personelin dhe studentët bëhet në përputhje me ligjin nr 887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"								
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke iu referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion u konstatua se institucioni, harton raporte analitike periodike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Ajo që GVJ konstatoi lidhet me faktin që gjurmimi studentëve lidhur me punësimin e tyre jepet në nivel universiteti dhe jo në nivel programi. Do ishte më efektive të kishim një informacion në nivel programi për të parë efektivitetin e tij.								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni përmbush të gjitha kriteret dhe rregullat në fuqi lidhur me përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret


Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe

Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, në këshillat studentore të fakulteteve të UNIEL bazuar në statutin e këtij institucioni dhe të akteve të tjera ligjore në fuqi. Përfshirja e studentëve

<p>atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>në një sërë strukturash vendimarrëse si Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Studentë në grupin e punës për akreditimin e programit etj. <i>EVIDENCE 2. I Lista e anetareve te Senatit akademik UNIEL</i></p>		
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve. Ato janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi gjithashtu që studentët jepnin mendimin e tyre lidhur me cilësinë në mësimdhënie, por jo në nivel programi dhe specifike për secilën lëndë. Ky është një element shumë i rëndësishëm në vlerësimin e një programi, pasi feedbacku duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe jo në nivel institucional. <i>GVJ sugjeron të mbahet në konsideratë vlerësimi i stafit akademik në nivel programi duke patur NJSBC funksionale edhe për këtë program studimi.</i></p>		
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ekzistues dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që njësia për vlerësimin e cilësisë së programit lidhur edhe me përfshirjen e studentëve, sapo kishte nisur të ngrihej dhe të funksiononte. Në nivel universiteti kjo strukturë ekzistonte, por edhe ajo nuk kishte një plan pune të qartë dhe të mirëstrukturuar lidhur me instrumentet përkatëse për të vlerësuar programin, lëndët, shprehur opinionet lidhur me kurrikulën etj. <i>GVJ e evidenton si një pikë të dobët mungesën e vlerësimeve nga pyetësorët e studentëve, analiza e të cilëve duhet të lidhet drejtpërdrejtë me lëndët, lektorin etj.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të institucionit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. <i>EVIDENCE 1.2 Rregulloret e Sfidimeve te UNIEL, neni 46, neni 49</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ sugjeron të mbahet në konsideratë vlerësimi stafit akademik në nivel programi duke patur NJSBC funksionale edhe për këtë program studimi. GVJ e evidenton si një pikë të dobët mungesën e vlerësimeve nga pyetësorët e studentëve, analiza e të cilëve duhet të lidhet drejtpërdrejtë me lëndët, lektorin etj.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi V.6
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka Zyrën e Karrierës vetëm në nivel universiteti, por jo pranë fakulteteve dhe departamenteve. Një rol shumë të rëndësishëm luan stafi akademik dhe ndihmës akademik në informimin e studentëve si dhe ofrimin e shërbimit ndaj tyre. Kjo bëhej me iniciativën personale të disa anëtarëve të punësuar me kohë të plotë ose te pjesshme. <i>Për këtë arsye, GVJ rithekson rëndësinë që ka këshillimi dhe orientimi karrierës edhe në nivel programi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se veprimtaria e kordinatorit të programit, njësia bazë dhe sekretaria orientohen drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen. Ashtu sikunder citohet edhe në RVB, të gjitha strukturat e IT, Zyra Këshillimit, ALUMNI etj janë në nivel institucional dhe nuk i shërbejnë drejtpërdrejtë këtij programi studimi. <i>Përsa më sipër, GVJ rekomandon krijimin e strukturave të posaçme për të qenë më pranë studentëve sipas cdo programi studimi, jo vetëm në nivel institucional.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore, mobilitete që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Për të kontaktuar persona që punojnë pranë kësaj zyre, studentët duhet të drejtohen në rektoratin e universitetit. Jo të gjithë kishin informacion rreth saj dhe mundësive që ajo ofron. <i>GVJ rekomandon që kjo zyrë të jetë më shumë prezente dhe të ushtrojë ndikimin e saj për të krijuar kontakte me kompani private në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës dhe ALUMNI mban të dhëna lidhur me punësimin e studentëve, por këto të dhëna janë sërish për të gjithë universitetin. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, nuk gjenden të dhëna specifike lidhur me ecurinë e mëtejshme të studentëve që kanë përfunduar studimet në Psikogji edukimi. <i>GVJ rekomandon të gjendet informacion më i detajuar në nivel programi.</i> <i>EVIDENCE 5.7 Te dhenat mbi punësimin e te diplomuarve 2020-2021/2021 – 2022</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Përsa më sipër, GVJ rekomandon krijimin e strukturave të posaçme për të qenë më pranë studentëve sipas cdo programi studimi, jo vetëm në nivel institucional. GVJ rekomandon që kjo zyrë të jetë më shumë prezente dhe të ushtrojë ndikimin e saj për të krijuar kontakte me kompani private në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Çdo vit akademik, çdo departament bën një analizë të detajuar të punës së departamentit ku përfshihen mendimet dhe sugjerimet e studentëve për lëndët dhe pedagogët, mendimet dhe sugjerimet e pedagogëve për mbarëvajtjen e lëndëve, si dhe raportimet e tyre. Pas kësaj analize, bëhen edhe ndryshimet respektive nëse ka të tilla. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, nuk gjejmë fakte evidente lidhur me këtë proces, por ndërkohë gjatë vizitës në institucion pedagogët shprehen që e zhvillojnë në rrugë informale. Bisedat me studentët ndikojnë në përmirësimin e metodave të mësimdhënies sipas tyre. Dokumentacioni i vetëm që ekziston është ai për mësimin online përmes platformës Microsoft Teams. Ky kriter nuk përmbushet sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, ndaj GVJ rekomandon të mbahet në konsideratë për më tej. <i>EVIDENCE 6.1 Guida e pedagogut: Mesimi online nepermjet Microsoft Teams</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Sistemi i brendshëm i cilësisë, funksionon i centralizuar, vetëm në nivel qëndror. Kjo strukturë ka pak kohë që ka nisur të ushtrojë aktivitetin e saj sipas rregullave dhe normave ligjore, pasi ende nuk ka unifikuar format e vlerësimit dhe procedura të tjera. Gjatë kontaktit me përfaqësues të kësaj strukture, u vu në pah mungesa e pyetësorëve të standartizuar të cilat duhet të përdoren më pas në cdo program studimi. Në këtë mënyrë mund të vlerësohen aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik. Përsa më sipër, GVJ e cilëson këtë si një pikë të dobët të institucionit lidhur me cilësinë e programit dhe vlerësimin e tij. Mungojnë dokumente mbështetëse të punës së këtyre strukturave.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë	Referuar dokumentacionin të dorëzuar dhe vizitës në institucion, konstatojmë që edhe pse kjo strukturë është ngritur në nivel universiteti, ndesh me vështirësi lidhur me përfshirjen e studentëve në nivel programi. Në departament ka disa iniciativa lidhur me hartimin e pyetësorëve dhe marrjen e opinionëve të studentëve, por ende të pa konsoliduara dhe




mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	përfunduara. Jepen disa raporte të përgjithshme, pa identifikuar lëndën dhe pedagogun. Kjo gjë nuk i shërben përmirësimit të programit dhe marrjen në konsideratë të ankimimeve. Në raportin e publikuar për vitin 2021 – 2022 jepet një informacion shumë i përgjithshëm dhe nuk identifikon problematikat e programit. GVJ rekomandon që këto struktura të mbështesin secilin program dhe të kryejnë vlerësime më të detajuara për të përmirësuar programin e studimit. <i>EVIDENCE 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i>		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pranë UNIEL është ngritur dhe funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore publikon rezultatet e mbledhura nga studentët, në nivel të përgjithshëm. <i>EVIDENCE 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022).</i>		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar të gjithë analizës së mësipërme, shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton sërish që analiza dhe administrimi pyetësorëve nuk zhvillohet për programin e studimit dhe stafin akademik specifikisht. Kjo gjë pengon më pas promovimin e praktikave të mira dhe nuk ndikon si një nxitje për personelin akademik në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Stafi akademik ka patur mundësi promovimi në programet e mobilitetit, por këto kanë qenë iniciativa të aplikimeve individuale të secilit prej tyre. Ky element shihet si një pikë e dobët për këtë program studimi, ndaj GVJ rekomandon të mbahet në konsideratë.		
Konkluzione	<i>GVJ ka shprehur më sipër opinionin sipas secilit kriter lidhur me këtë standard. Në përfundim mund të themi që ky element është një pikë e dobët për këtë program studimi pasi nuk trajton analiza të mirëfillta që i shërbejnë drejtpërdrejtë këtij programi studimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Struktura organizative e Universitetit të Elbasanit është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 si për nga organizimi, ashtu edhe nga ndarja e detyrave të cilat janë të përshkruara në rregulloren e institucionit. Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Sektori Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ndërkohë referuar RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar, mungon Komisioni i Vlerësimit të Performancës i cili duhet të funksionojë në nivel të njësisë kryesore. Ky komision ka në fokus jo vetëm performancën


	<p>e stafit akademik por edhe të vetë strukturave të tjera të njësisë kryesore. Përmes këtij komisioni matet dhe vlerësohet performanca e individëve dhe performanca e proceseve akademike si procesi akademik, procesi kërkimor, vlerësimi i çështjeve studentore, vlerësimi i marrëdhënieve me komunitetin dhe vlerësimin e procesit të administrimit dhe zhvillimit institucional. GVJ konstaton që kjo strukturë ekziston në nivel qëndror dhe sapo ka nisur procedurat në nivel fakulteti. Nuk zotërojmë një dokumentacion mbështetës për të vlerësuar më mirë punën e kryer. (EVIDENCE 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022). (EVIDENCE 6.3 Urdherat për zhvillimin e pyetesorve instiucionale 2021-2022)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në FSHS, konstatoi se Sistemi i brendshëm i cilësisë, funksionon si një rrjet në nivel qëndror dhe ka nsiur të ngrejë struktura në njësitë kryesore. Ky komision ka në përbërje të tij staf akademik me eksperiencë në IAL si dhe student. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të dorëzuar, evidentohet personel akademik me eksperiencë i ftuar gjatë viteve 2018 – 2022. <i>Evidencë 6.4. Lista e personelit të ftuar të angazhuar në fakultetin FSHE.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat zyrtare që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi. Për sigurimin e cilësisë në nivel qëndror institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. Referuar akreditimit institucional, institucioni ka marrë vlerësimin maksimal. <i>EVIDENCE 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe RVB, nuk evidentojmë tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Ndërkohë gjatë vizitës në institucion dhe intervistave të zhvilluara me personelin akademik u diskutuan instrumente të ndryshme që përfshijnë vetëraportime të pedagogëve, raportime në nivel departamenti, monitorim nga njësia e sigurimit të cilësisë, të procesit mësimor si dhe mendime nga studentët. GVJ rekomandon që këto dokumente të formalizohen dhe të jenë më të matshëm për të promovuar punën e gjithësecilit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton që kjo strukturë (SBC) ekziston në nivel qëndror dhe sapo ka nisur procedurat në nivel fakulteti. Nuk zotërojmë një dokumentacion mbështetës për të vlerësuar më mirë punën e kryer.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



Standardi VI.3


Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve. Për të nxitur dhe monitoruar procese të tilla një rol kyç luan Departamenti. Ky i fundit luan një rol të rëndësishëm në organizimin e procesit mësimor, rishikimin dhe vlerësimin sistematik për përmirësimin e planeve mësimore të programeve të studimit. Gjatë takimit me grupin e punës dhe përfaqësues të departamentit, u citua që është bërë një ndryshim në planin mësimor të këtij programi, por ë dokumentacion nuk gjendet i reflektuar.</p> <p><i>GVJ konstaton që në funksion të përmirësimit të cilësisë rekomandohen të kryhen vlerësime periodike duke marrë feedback nga të gjithë aktorët.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Referuar RVB, dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion nuk evidentohen praktika aktuale që dëshmojnë përmirësimin më së miri të këtij kriteri. Ekziston vetëm një dokument në nivel universiteti lidhur me vlerësimin përmes pyetësorëve të plotësuar nga studentët, por që nuk jep fakte dhe detaje për këtë program studimi specifikisht.</p> <p><i>GVJ ka konstatuar që nuk përmirësohet me mjete dhe instrumente adresimi i mangësive dhe përmirësimi në vijim i cilësisë, si rrjedhojë nuk gjendet e aplikuar edhe motivimi i arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare,</p>	<p>UNIEL në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit shprehet në RVB se përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit, përdor një pyetësor në nivel institucional, ka atashuar të dhënat e përfuara nga analiza e rezultateve, por ato nuk i shërbejnë drejtpërdrejtë këtij programi studimi. Raport është i përgjithshëm dhe nuk evidenton cilat janë problematikat specifike sipas të gjithë komponentëve të programit të studimit.</p> <p><i>Përsa më sipër, GVJ citon sërish që kjo duhet të mbahet në konsideratë për të vazhduar më tej.</i> Dokumenti vetëm që dëshmon përmirësimin e këtij kriteri është <i>Evidenca 6.2. Publikimi raportit 2021 – 2022.</i></p>



si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Institucioni kryen vlerësime periodike të centralizuara përmes njësisë së ngritur pranë universitetit. Kjo strukturë ka aplikuar pyetësor për studentët; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. SBC në nivel njësie kryesore është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit. Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe cilësisë së programit të studimit realizohen dhe monitorohen rezultatet e studentëve në provime, rezultatet e studentëve në realizimin e detyrave të ndryshme gjatë kursit, monitorim gjatë praktikës si dhe monitorimi procesit të mësimdhënies. <i>GVJ nuk gjen dokumente mbështetëse që dëshmojnë punën që bën institucioni në këtë drejtim, duke i shërbyer këtij programi studimi, përveç raportit që është përmendur shumë herë gjatë RVB.</i> Edhe ky kriter mbetet një pikë e dobët në këtë program.								
Konkluzione	<i>GVJ ka konstatuar që nuk përmbushet me mjete dhe instrumente adresimi i mangësive dhe përmirësimi në vijim i cilësisë, si rrjedhojë nuk gjendet e aplikuar edhe motivimi i arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. GVJ konstaton që në funksion të përmirësimit të cilësisë rekomandohen të kryhen vlerësime periodike duke marrë feedback nga të gjithë aktorët. GVJ nuk gjen dokumente mbështetëse që dëshmojnë punën që bën institucioni në këtë drejtim, duke i shërbyer këtij programi studimi, përveç raportit që është përmendur shumë herë gjatë RVB.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UNIEL përpiket të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të paramentrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit. <i>Evidencë 1.13. Marrëveshje bashkëpunimi</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të



<p>njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e sigurimit të cilësisë. Kjo strukturë përmes aktiviteteve që ndërmerr synon të garantojë sigurimin e cilësisë. GVJ konstaton që institucioni ka mungesë dokumentacioni shoqërues për të mbështetur përmbushjen e këtij kriteri, por mbështetet vetëm në atë që thonë anëtarët e kësaj strukture.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UNIEL si një njësi e Arsimit të Lartë, ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni etj). Gjithashtu, edhe përfshirja e studentëve në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve. Nuk gjenden të dhëna mbështetëse në dokumentacion që dëshmojnë përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore në këtë proces, por vetëm dokumentacioni në nivel qëndror. Gjatë takimit në institucion, GVJ pati mundësi të kontaktojë me përfaqësues nga fakulteti, por mungojnë të dhëna të dokumentuara që dëshmojnë punën e kryer nga këta anëtarë.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës dhe përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve. <i>EVIDENCE 6. 5 Kodi i Etikës UNIEL</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm, pedagogë me kohë të pjesshme, përfaqësues të institucioneve partnere, ish student alumni. Mendimet dhe ekspertiza e tyre vjen nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve. Kjo gjë u evidentua edhe gjatë vizitave në institucion, ku personeli me kohë të pjesshme ishte aktiv dhe pjesëmarrës në takimet e zhvilluara me GVJ.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nuk gjenden të dhëna mbështetëse në dokumentacion që dëshmojnë përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore në këtë proces, por vetëm dokumentacioni në nivel qëndror.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat, strategjitë e organizimit të veprimtarive, raportet periodike janë transparente dhe publikohen edhe në faqen zyrtare të UNIEL, por sërish kemi një raport të përgjithshëm, pa identifikuar problematikat në nivel programi studimi. Edhe pse UNIEL ka ngritur struktura duke shkuar në nivel fakulteti, informacioni që mblidhet nuk i shërben drejtpërdrejtë programit të studimit.</p> <p>Në funksion të trasparencës do të ishin të nevojshme vijimi i praktikës të nisur si diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin trasparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, dhe gjithashtu do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Përsa më sipër GVJ rekomandon që në raportet e tjera të jepen rubrika specifike për çdo program studimi, lënde dhe lektor. Në këtë mënyrë mund të shkojmë në detaje dhe mund të përmirësojmë ndjeshëm cilësinë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike – profesionale.</p> <p>Duke iu referuar RVB gjetjet e vlerësimit të brendshëm janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e UNIEL.</p> <p><i>EVIDENCE 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.</i> <i>EVIDENCE 6. 5 Kodi i Etikes UNIEL</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit, si dhe raporti vjetor i departamentit përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga plan veprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik. Referuar RVB, dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, <i>GVJ konstaton sërish që raportet e publikuara mbeten të përgjithshme dhe nuk kanë një plan konkret përmirësimi që lidhet drejtpërdrejtë me këtë program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Akreditimi është një proces me rëndësi dhe ndihmon fuqishëm për marrjen e vendimeve për të bërë ndryshime profilizuese të programit të studimit, për disa arsye:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, vlerësimi i jashtëm i programit të studimit nga ekspertët dhe rekomandimet e bëra prej tyre, mund të nxjerrin në pah nevojën për përmirësime të programit të studimit; - Së dyti, vlerësimi i brendshëm tërësor i programit të studimit, gjithashtu nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit; - Së treti, akreditimi i programit realizohet pas ofrimit, për një periudhë të caktuar kohe, kur mësimdhënia është konsoliduar, rezultatet e studentëve kanë dalë disa herë dhe nevojat për përmirësim janë më të bazuara. <p>Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vetë institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të</p>

	studimit, si dhe ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Ekipi i Vlerësimit të Brendshëm organizon veprimtari periodike me personelin dhe me studentet për informimin ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në FSHS, GVJ konkludon se institucioni me anë të veprimtarive periodike si “Open days”, sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik, realizon informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Një sërë strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre staf akademik dhe studentë me qëllimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton sërish që raportet e publikuara mbeten të përgjithshme dhe nuk kanë një plan konkret përmirësimi që lidhet drejtpërdrejtë me këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Psikologji Edukimi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:



1. Programi i studimit “Master i shkencave” në “Psikologji Edukimi”, është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe të Departamentit të Psikologjisë në Universitetin e Elbasanit;
2. Universiteti i Elbasanit ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor për programin e studimit;
3. Stafi akademik dhe ai administrativ janë në mbështetje të studentëve dhe shumë pranë tyre;
4. Universiteti ofron akses në biblioteka online ku studentët mund të aksesojnë shumë libra në fushën e psikologjisë. Kjo bibliotekë është një vlerë e shtuar për institucionin;

b. Pika të dobta:

1. Dokumentat rregullatorë dhe strategjikë të departamentit dhe të programit të studimit duhet të reflektojnë koherencën dhe zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, të akteve rregullative mbi profesionet e rregulluara dhe ligjit mbi Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë dhe të Strategjive Kombëtare të zhvillimit; (*standarti II.3. kriteri 2; standarti II.5. kriteri 3*)
2. Mungesa e mobilitetit të studentëve nga programi i studimit “Master i shkencave” në “Psikologji Edukimi” drejt programeve të ngjashme në universitete jashtë vendit dhe anasjelltas; (*standarti I.3. kriteri 3*).
3. Mungesa e përputhshmërisë së planit mësimor të programit të studimit me VKM 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) në organizimin e tij, në peshën specifike të komponentëve të veprimtarive formuese dhe në lëndët e përcaktuara për komponentët A dhe C në planet mësimore për ciklet e studimit 2019-2021, 2020-2021, 2022-2024; (*standarti II.1. kriteri 1, kriteri 3*).
4. Mungesa e evidencave të përmirësimit dhe përditësimit të përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme si në elementët e planit mësimor të programit të studimit edhe në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve dhe moduleve të ofruara në programin e studimit; (*standarti II.3, kriteri 5*).

Rekomandime

- 1- Të harmonizohet baza ligjore dhe përmbajtja dokumentave rregullatorë dhe strategjikë të departamentit dhe të programit të studimit me aktet e reja ligjore dhe nënligjore në arsimin e lartë, të akteve rregullative mbi profesionet e rregulluara dhe ligjit mbi Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë, me Strategji Kombëtare zhvillimi;
- 2- Institucioni të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit “Master i shkencave” në “Psikologji edukimi”, në mënyrë që të ketë tregues të studentëve përfitues nga programet e shkëmbimit;
- 3- Që prej hyrjes në fuqi të VKM 41 në Janar të vitit 2018 e deri në vitin akademik 2021 në planin mësimor të programit të studimit ka patur papërputhshmëri të peshës specifike të veprimtarive formuese me VKM. Në planin mësimor të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji edukimi” për ciklin e studimit 2022-2024 është realizuar përputhja e peshës specifike të kategorive të veprimtarive formuese me VKM 41, por sugjerojmë që Departamenti i Psikologjisë të rikonsiderojë përkatësinë e lëndëve të komponentit mësimor të kategorisë A dhe C, pasi nuk përputhen me përcaktimet e vendimit të cituar;
- 4- Departamenti i Psikologjisë, rekomandohet të konsiderojë përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme sipas objektivave strategjikë të zhvillimit të departamentit dhe të programit të studimit;
- 5- Të bëhen përpjekje për të rritur numrin stafit akademik me formim bazë dhe të vazhduar në psikologji dhe sugjerohet që personeli akademik i programit të studimit të licensohet nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë;
- 6- Të hartohen dhe të implementohen politika të qarta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në mënyrë që procesi të shërbejë përmirësimit të cilësisë nëpërmjet strategjive të ndërhyrjes;
- 7- Të hartohet dhe të implementohet një strategji për t’u bërë programin e studimit atraktiv për studentët dhe për të siguruar rregjistrimin e tyre në këtë program studimi;



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Psychology of Education"

a. Strengths and Affirmations:

1. The study program "Master of Science" in "Psychology of Education" is in accordance with the academic field of the Faculty of Education Sciences and the Department of Psychology at the University of Elbasan;
2. The University of Elbasan has effective policies to increase partnerships and cooperation with institutions, companies, third parties, local and/or foreign business actors in order to realize the study program, within the framework of professional training, professional practices and scientific research for the study program;
3. The academic and administrative staff support the students and are very close to them;
4. The university provides access to online library where students can access the literature in the field of psychology. This library is an added value for the institution;

b. Weaknesses:

1. The regulatory and strategic documents of the department and the study program must be in compliance with the law and by-laws for higher education in the Republic of Albania, the regulatory acts on regulated professions and the law of Psychologists Order in the Republic of Albania and the National Development Strategies. *(Standard II.3. criterion 2; standard II.5. criterion 3)*
2. The lack of mobility of students from the "Master of Science" study program in "Psychology of Education" to similar programs in universities abroad and vice versa; *(Standard I.3. criterion 3)*
3. Lack of compatibility of the curriculum of the study program with Decision 41, dated 24.01.2018 (amended); *(Standard II.1. criterion 1&3)*
4. Lack of evidence of continuous improvement and updating of the content of the study program, both in the elements of the curriculum of the study program and in the content of the syllabuses of the modules offered in the study program; *(Standard II.3. criterion 5)*

Recommendation

- 1- To harmonize the basic documents of the study program and the department with the higher education law no. 80/2015, with the law on regulated professions and the law on the Order of Psychologists in the Republic of Albania, with various National Development Strategies;
- 2- The institution should work more towards promoting the mobility of students of the "Master of Science" study program in "Psychology of Education", to have indicators of students benefiting from exchange programs;
- 3- We suggest that the Department of Psychology reconsider the relevance of the subjects of the teaching components of category A and C, since they do not comply with the determinations of Decision 41, dated 24.01.2018 (amended);
- 4- The Department of Psychology is recommended to consider improving and updating the content of the study program on an ongoing basis according to the strategic objectives of the development of the department and the study program;

- 5- Efforts should be made to increase the number of academic staff with basic and advanced training in psychology and it is suggested that the academic staff of the study program be licensed by the Order of Psychologists in the Republic of Albania;
- 6- To draft and implement clear policies for the evaluation of the quality of the study program and of the academic personnel engaged in the study program so that the process serves to improve quality through intervention strategies;
- 7- To design and implement a strategy to make the study program attractive for students and to ensure their registration in this study program;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

